



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

NR. 136 AKTI

NR. 105 VENDIMI

Tiranë, më 12.02.2019

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Valbona Sanxhaktari	Kryesuese
Lulzim Hamitaj	Anëtar
Genta Tafa (Bungo)	Relatore

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Fiorela Mandro, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Branko Hrvatin, më datë 08.02.2019, ora 09:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (underground), Tiranë, zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Elsa B. Toska**, këshilltare ligjore në Gjykatën Kushtetuese, e cila kërkoi konfirmimin në detyrë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE : Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH, E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar” (referuar më poshtë “Kushtetuta”).

Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (referuar më poshtë “ligji nr. 84/2016”);

Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi gjetjet dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Genta Tafa (Bungo), mori në shqyrtim dhe analizoi shpjegimet dhe provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, pasi shqyrtoi dhe analizoi çështjen, duke u bazuar në të tre kriteret e vlerësimit, atë pasuror, të figurës dhe vlerësimin profesional, mbështetur në pikat 1 dhe 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

Subjekti i rivlerësimit, znj. Elsa Toska, ushtron detyrën e këshilltares ligjore në Gjykatën Kushtetuese dhe, në bazë të pikës 4 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*.

Ajo i është nënshtruar procedurave të rivlerësimit, duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur më datë 15.5.2018 në përputhje me “Rregullore për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”.

Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 24.05.2018 u caktua me mirëkuptim kryesuesi i tij, zonja Valbona Sanxhaktari, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga asnjë prej anëtarëve të trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin Elsa Toska.

Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016 pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit (ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) dhe Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë (KLD).

Këto raporte janë administruar nga relatori me fillimin e hetimit administrativ.

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI) ka kryer procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar me shkresën nr. *** prot., datë 10.04.2018, protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot, datë 10.04.2018, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të të cilit ka konstatuar se:

- deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;
- ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- ka kryer fshehje të pasurisë;
- ka kryer deklaram të rremë;
- subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar një raport me shkresën nr. *** prot., datë 30.10.2017, për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit 84/2016, deklasifikuar plotësisht me vendimin e KDZH-së nr. ***, datë 09.07.2018, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të të cilit ka konstatuar *përshatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, znj. Elsa Toska.*

Këshilli i Lartë i Drejtësisë (KLD) ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe 5 dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar me nr. *** prot., datë 22.10.2018.

Në vijim, nga ana e relatorit të çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në nenin 14, pika 5, të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm.

Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, më datë 25.01.2019 vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit, si dhe njoftimin e këtij subjekti për t`u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni, si dhe rezultatet e hetimit, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

Subjekti i rivlerësimit u njoftua mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkojë marrjen e provave të reja, lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga ana e Komisionit më datë 25.01.2019. Subjekti i rivlerësimit u njoh me aktet e dosjes dhe ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe provave të reja më datë 05.02.2019.

Pas shqyrtimit të këtyre shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, trupi gjykues, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore.

II. SEANCA DËGJIMORE

Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht, më datë 06.02.2019.

Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, më datë 08.02.2019, ora 09:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (underground), Tiranë, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Branko Hrvatin.

Në këtë seancë, subjekti i rivlerësimit u paraqit dhe u mbrojt personalisht, duke shprehur opinionin e tij në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer.

Në përfundim, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Znj. Elsa Toska ka qenë bashkëpunuese në procesin e rivlerësimit ndaj saj, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ. Ajo ka zbatuar me përpikmëri afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur. Subjekti i rivlerësimit ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016.

A. VLERËSIMI I PASURISË

Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) provat e dorëzuara nga vetë subjekti pranë ILDKPKI-së në “deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar, Vetting”;
- b) raportin e dorëzuar pranë Komisionit nga ILDKPKI-ja;
- c) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
- ç) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik;
- d) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit;
- dh) deklaratimet e personave të tjerë të lidhur.

Në deklaratën e pasurisë “Vetting”, të dorëzuar pranë ILDKPKI-së, subjekti deklaron këto pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme:

1. **Makinë “Opel Astra Classic”**, marrë me leasing në korrik 2010; kredi e mbyllur në qershor 2013; vlera 13.300 euro;

Burimi i deklaruar i krijimit sipas deklaratës VETTING: Kredi 10.000 euro marrë nga M. T., kaluar kredia Elsa Toskës në shumën 8.565,74 euro në vitin 2011.

Subjekti ka vënë në dispozicion:

- Kontratë e qirasë financiare nr. *** datë 01.11.2011;
- Kontratë shitje nr. ***, datë 14.06.2013;

Hetimi i kryer nga Komisioni:

- Shkresë nr. *** prot., datë 4.6.2018 drejtuar Drejtorisë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor Tiranë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor.

Kthim përgjigje nr. *** prot., datë 13.06.2018;

Kthim përgjigje nr. *** prot., datë 8.6.2018;

Kthim përgjigje nr. *** prot., datë 27.06.2018

- Shkresë nr. *** prot., datë 04.06.2018 drejtuar bankave të nivelit të dytë.

Kthim përgjigje Banka Credins nr. *** prot., datë 15.08.2018.

- Shkresë nr. *** prot., datë 26.09.2018 drejtuar BANKA CREDINS sh.a.

Kthim përgjigje Banka Credins sh.a nr. *** prot., datë 08.10.2018.

Arsyetimi ligjor

Bazuar në shkresën e DPSHTRR rezulton se subjekti i rivlerësimit ka në pronësi mjetin me targa ***, ndërsa bashkëshorti i saj ka në pronësi ka mjetin me targa ***.

- A. Në datë 27.07.2010 është lidhur kontrata e shitblerjes me blerës “****” sh.a shitësi “****” sh.p.k dhe porositës “****” sh.p.k me çmim shitje 13.300 euro.

Më datë 30.07.2010 është lidhur kontrata e qirasë financiare nr. *** nga ana e shoqërisë *** sh.p.k me “****” sh.a. Bazuar në nenin 3.2 të kontratës, nga ana e shoqërisë “****” sh.p.k, është parapaguar shuma 2,660 euro, duke mbetur si shumë e financuar për këtë mjet shuma 10.640 euro. Dorëzanës për këtë kontratë rezulton z. M. T.

Më datë 1.11.2011 është lidhur aneks kontratë nr. *** me qëllim kalimin e të gjitha të drejtave dhe detyrimeve, që rrjedhin nga kontrata e qirasë financiare nr. *** të tretëve. Në pikën III të

kontratës, Shoqëria “****” sh.p.k, në cilësinë e qiramarrësit, deklaroi se për arsye personale heq dorë nga të drejtat dhe detyrimet që linden nga kontrata e qirasë financiare nr. *** si dhe paraqet kërkesën tek qiradhënësi që të bëhet kalimi i të drejtave dhe detyrimeve të kësaj kontrate tek qiramarrësi i ri, subjekti i rivlerësimit, duke filluar nga data 02.10.2011. ***, në cilësinë e qiradhënësit, aprovon kalimin e të drejtave dhe detyrimeve që rrjedhin nga kontrata e qirasë financiare nr. *** tek qiramarrësi i ri, subjekti i rivlerësimit, duke filluar nga data 2.10.2011. Shuma e mbetur e financimit është përcaktuar 8.564.74 euro.

Po më datë 1.11.2011, me qëllim formalizimin e kalimit të drejtave dhe detyrimeve të kontratës së qirasë financiare nr. ***, është lidhur kontrata e qirasë financiare nr. *** midis subjektit të rivlerësimit dhe “****” sh.a, çmimi është përcaktuar në vlerën 8.565.74 euro. Afati i kontratës është përcaktuar 46 muaj. Me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 14.06.2013, është realizuar kalimi i pronësisë së automjetit OPEL ASTRA CLASSIC, ngjyrë gri, targa ***.

Në lidhje me pagesat për këtë automjet është pyetur subjekti i rivlerësimit, i cili ka deklaruar se pagesat e të gjitha kësteve për këtë mjet janë mbuluar nga të ardhurat e saj familjare.

Në lidhje me aftësinë paguese të subjektit të rivlerësimit për të shlyer mjetin tip “Opel Astra”, pasi u krye analiza financiare për vitin përkatës, rezulton se subjekti ka patur aftësi paguese:

Analiza financiare	2010	2011	2012	2013
Të ardhurat neto nga pagat Sr	1061387	1452465	1448202	1559234
Të ardhura neto të bashkëshortit	320000	312000	205060	224704
Të ardhura të tjera honorare	478978	597184	461940	188373
Të ardhura të tjera interesa	4233	4650	4397	4984
Total të ardhura	1864598	2366299	2119599	1977295
Leasing, qira financiare	457941	61371	895882	366196
Shpenzime të tjera të ndryshme, pyetësor	35000	280787	56000	292520
Shpenzime arredimi ndarë në vite	233300	233300	233300	233300
Pagesë shpenzime jetese	640000	640000	640000	640000
Shpenzime total	1366241	1215458	1825182	1532016
Ndryshim mj.monetare banke gj. fillim-gj. fund periudhe	139142	242631	26752	-100266
Mjete monetare të disponueshme	637500	1393472	321169	345013
Pagesa për blerje pasurie	0	0	0	0
Detyrime	0	0	0	0
Pasuri neto	0	0	0	0
Balanca e fondeve	637500	1393472	321169	345013

✓ Përputhet deklarimi i subjektit më të dhënat e administruara nga hetimi administrativ.

B. Me anë të shkresës së DPSHTRR-së nr. *** prot., datë 27.06.2018, informohemi se subjekti ka në pronësi edhe një automjet tjetër, që nuk rezulton i deklaruar në deklaratën “Vetting”.

Nga hetimi rezulton se:

- Me kontratën e dhurimit nr. ***, datë 16.06.2001, mes dhurueses M.T. (motra e bashkëshortit të subjektit, me banim në Gjermani) dhe pranuesit të dhurimit M.T. është realizuar kalimi i pronësisë së automjetit BMW Seria 3/1.
- Automjeti mban targën *** dhe vijon të jetë në pronësi të M. T.
- Ky automjet rezulton i deklaruar në deklaratën e interesave private të vitit 2003, si i dhuruar.
- Bashkëshorti i subjekti të rivlerësimit në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës të **datës 24.04.2007** ka deklaruar se ka në pronësi mjetin tip BMW blerë në vitin 2000 me vlerë 2.000 USD.
- Nga shkresat e DPSHTRR-së dhe nga vetë Drejtoria Tiranë nuk rezulton që automjeti i dhuruar në vitin 2001 të jetë tjetërsuar apo çregjistruar dhe për pasojë nxjerrë nga qarkullimi.

I pyetur në lidhje me këtë mjet, subjekti i rivlerësimit deklaroi se: *“Më datë 23.06.2011, bashkëshorti ia ka kaluar me prokurë të posaçme¹ të drejtën e përdorimit, por edhe të shitjes një personi tjetër.”* Nga kjo periudhë subjekti deklaroi se ata nuk e kanë patur më këtë makinë në përdorim.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të depozituar nga subjekti, konstatohet se:

- Me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 13.06.2007 mjeti është shitur nga M. T. tek “****” sh.p.k (me ortak të vetëm dhe administrator M. T.) për vlerën 300,000 lekë. Për kryerjen e kësaj pagesë subjekti i rivlerësimit ka depozituar mandat pagesë nr. *** datë 31.12.2007.
- Me prokurën e posaçme nr. ***, datë 23.06.2011, M. T. i kalon të drejtat e përdorimit, si dhe disponimit, për këtë mjet, zotit F. B.
- Me kontratën e shitblerjes nr. *** datë 29.09.2012, zoti F. B., me cilësinë e përfaqësuesit të z. M. T., ia shet këtë mjet z. J. D. për shumën 35,000 lekë.

Në përfundim të hetimit, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës:

- ⊗ Ka mospërputhje midis deklarimeve të subjektit të rivlerësimit në deklaratën e interesave private të vitit 2003 dhe para fillimit të detyrës (2007) në lidhje me mjetin tip BMW, ku një herë është deklaruar i dhuruar dhe një herë i blerë.
- ⊗ Shitja e këtij mjeti nuk rezulton e deklaruar në asnjë nga deklaratat periodike të interesave private të subjektit të rivlerësimit.

¹ Prokurë nr. ***, datë 23.06.2011.

Në shpjegimet e paraqitura me shkrim subjekti ka pranuar se ka mospërputhje mes deklarimit të vitit 2003 dhe atij 2007 për mënyrën e fitimit të pronësisë së këtij mjeti, por kjo mospërputhje është një ngatërrësë e mënyrës së deklarimit të bashkëshortit të saj, e paqëllimshme. Dhurimi i këtij mjeti nga kunata te bashkëshorti vërtetohet me kontratën e dhurimit të qershorit 2001.

Nga dokumentacioni i depozituar nga subjekti konstatohet se mjeti është blerë në Gjermani nga M.T. dhe është zhdoganuar për shumën 163.537 lekë.

Më pas, në vitin 2007, ky mjet ka kaluar në pronësi të “****” sh.p.k për shumën 300, 000 lekë. Sipas shpjegimeve të subjektit, kjo shitje është realizuar për të qenë pjesë e bilanceve të shoqërisë, konkretisht shpenzimeve të zbritshme, pasi automjeti përdorej nga zoti M. T. për nevojat e “****” sh.p.k dhe ndërkohë shpenzimet për mirëmbajtjen, i bënte si individ. Duke dashur që t'i njiheshin këto shpenzime, si shpenzime të shoqërisë, atëherë ai, sipas këshillës së financierit, ia shiti “****” sh.p.k dhe e përfshiu tek asetet e shoqërisë.

Më tej subjekti sqaron se e drejta përdorimit dhe e shitjes së këtij mjeti i është kaluar shtetasit F.B., në 2011, sipas kontratës që Komisioni disponon. Subjekti deklaron se: “Ky kalim është bërë, jo për arsye fitimprurëse, por pasi ne nuk kishim të ardhura të mbanim dhe të mbulonim shpenzime për dy automjete në shtëpi, pas marrjes me leasing të makinës “Opel Astra” në korrik 2010. BMW ishte shumë e vjetër, (më tepër, si për scrap, sipas vlerësimit tonë), prodhim i vitit 1989, dhe kishte kosto të lartë mirëmbajtjeje, duke konsideruar parkimin privat mujor, dokumentacionin vjetor të siguracionit, kolaudimit, apo shërbime të tjera mbi të. Po ashtu, ajo nuk ishte më e nevojshme për përdorim as për “****” sh.p.k, pasi kjo shoqëri në atë kohë nuk kishte aktivitet.”

Shitja e kësaj makine është bërë në vitin 2012, sipas kontratës së shitjes që Komisioni, gjithashtu, e disponon. Në lidhje me faktin se, megjithëse e shitur, mjeti figuron ende në emër të pronarit të parë, subjekti ka shpjeguar se është përgjegjësi e blerësit çregjistrimi dhe vënia në emrin e tij e mjetit të blerë. Ky deklarimi i subjektit përputhet me parashikimet e nenit 93 të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë.²

² 1. Në rast ndryshimi pronësie të automjeteve, motomjeteve dhe rimorkiove ose në rastin kur i jepen në përdorim të tjerëve a kur lidhen marrëveshje për qiradhënie me të drejtë blerjeje, dega përkatëse e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, sipas kërkesës së paraqitur nga ana e interesuar, brenda 10 ditëve nga data kur nënshkrimi i aktit është vërtetuar ose është gjykuar i rregullt, merr masa për regjistrimin e ndryshimit të pronësisë ose të ndryshimeve të tjera, si dhe për lëshimin e certifikatës së re të pronësisë.

2. Zyra e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, sipas kërkesës së paraqitur nga pronari brenda afateve të përcaktuara në pikën 1, merr masa për rinovimin ose azhurnimin e lejes së qarkullimit që pasqyrojnë ndryshimet e treguara në pikën e mësipërme. Në mënyrë të ngjashme veprohet edhe për ndryshimin e vendbanimit.

3. Cilido që nuk respekton dispozitat e përcaktuara nga ky nen, ndëshkohet me masë administrative me gjobë nga dhjetë mijë deri në dyzet mijë lekë.

4. Cilido që qarkullon me një mjet, për të cilin nuk është kërkuar, brenda afatit të caktuar në pikën 1 dhe 2, azhurnimi ose rinovimi i lejes së qarkullimit dhe i certifikatës së pronësisë, ndëshkohet me masë administrative me gjobë nga pesë mijë deri në njëzet mijë lekë.

5. Leja e qarkullimit i merrret menjëherë atij që kryen shkeljet e parashikuara në pikën 3 dhe i dërgohet zyrës së Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, që merr masa për rinovimin e saj pas zbatimit të dispozitave që janë shkelur.

Në lidhje me mosdeklarimin e shitjes së këtij mjeti në vitin 2012, subjekti ka sqaruar se: *“Nuk e kam deklaruar në DPV 2012 si të shitur, për shkak pakujdesie njerëzore, dhe as në deklaratën “Vetting” nuk e kam deklaruar, duke menduar se nuk e kisha më në përdorim apo zotërim si pasuri të luajtshme në kohën e deklarimit, janar 2017, dhe mbi të gjitha se nuk ka pasur impakt financiar kjo makinë për të vënë pasuri të mëtejshme, përmes fitimit nga shitja e saj.”*

Ky deklarimi i subjektit të rivlerësimit përputhet me rezultatet e hetimit administrativ, pasi nga ana e saj të ardhurat nga shitja e këtij mjeti nuk kanë shërbyer si burim për blerjen e ndonjë pasurie.

Në përfundim të hetimit administrativ, pasi shqyrtoi shpjegimet dhe provat e subjektit, Komisioni konkludon se:

- ✓ Subjekti është treguar i pakujdesshëm në plotësimin e deklaratës së vitit 2007, duke deklaruar blerje të mjetit tip BMW, prodhim i vitit 1989, kur ishte fituar në fakt nëpërmjet dhurimit. Por kjo pakujdesi nuk mund të ndikojë në vlerësimin pasuror për këtë subjekt, përderisa provohet dhurimi me dokumentacion ligjor dhe nuk ka pasoja në deklarimin “Vetting” për sa kohë të ardhurat e siguruar nga ky mjet nuk kanë shërbyer si burim për blerjen e ndonjë pasurie tjetër.
- ✓ Mosdeklarimi i shitjes së këtij mjeti në deklarimin e vitit 2012 për shumën 35, 000 lekë, mund të jetë për shkak të një pakujdesie njerëzore, siç pretendon subjekti. Vlera e shitjes së mjetit është e tillë që nuk mund të merret në konsideratë për fshehje apo deklarim të rremë.

2. Gjendja e llogarive në **Raiffeisen Bank**:

- a. Llogari rrjedhëse në lekë me gjendje: 741,55 lekë.
- b. Llogari bankare “Raiffeisen”, obligacion 2-vjeçar, interesi 3,6%. Gjendja: 1.000.000 lekë;
- c. Llogari rrjedhëse në euro, gjendja: 444 euro.
- d. Llogari “KID” V. T. në shumën 10, 000 lekë.

Burimi i deklaruar i krijimit sipas deklaratës “VETTING”: Të ardhura nga projektet

Për këtë pasuri, subjekti ka vënë në dispozicion:

- Vërtetim mbi shpalljen fitues datë 27.12.2016 Raiffeisen Bank;
- Nxjerrje llogarie Raiffeisen Bank në lekë në emër të subjektit të rivlerësimit;
- Nxjerrje llogarie Raiffeisen Bank në euro në emër të subjektit të rivlerësimit;
- Depozitë për të tretë datë 06.01.2017 në Raiffeisen Bank për znj. V. T.;
- Kontratë llogarie rrjedhëse Raiffeisen Bank në lekë në emër të znj.V. T.

Hetimi i kryer nga ana e Komisionit:

- Shkresë nr. *** prot., datë 04.06.2018 drejtuar bankave të nivelit të dytë;

Raiffeisen Bank sh.a., me shkresën nr. *** prot., datë 07.06.2018, vë në dispozicion informacionin e kërkuar.

Arsyetimi ligjor

Nga ana e Raiffeisen Bank informohemi se subjekti i rivlerësimit ka llogaritë e mëposhtme:

- Llogari page me gjendje 300,717 lekë. Gjendja në datë 31.12.2016 ka qenë 741.55 lekë
- Subjekti i Rivlerësimit ka blerë obligacione të thesarit në tregun primar nga Raiffeisen Bank në vlerën 1,000,000 lekë. Bazuar në pasqyrat e gjendjeve të llogarive të subjektit të rivlerësimit në Bankën Raiffeisen, rezulton se ajo disponon dy fonde të investuara në obligacione:
 - Obligacione me afat 2-vjeçar (22.12.2016 – 22.12.2018) në shumën 1.000.000 Lekë;
 - Obligacione me afat 10 vjeçar (11.01.2018 – 11.01.2028) në shumën 732.081 Lekë.
- Në datë 12.12.2016, Subjekti i rivlerësimit ka depozituar *cash* në llogarinë e pagës shumën 1.000.000 lekë me përshkrimin “*Elsa Toska derdh në llogari të ardhura nga kursimet, shpërblime, projekte*”, në të njëjtën datë shuma ka kaluar në llogarinë në lek për të investuar në letra me vlerë në emër të subjektit të rivlerësimit dhe në datë 22.12.2016 është transferuar me përshkrimin “investim për ankandin”.

Nga ana e Komisionit është kryer analiza financiare mbi mundësinë e subjektit të rivlerësimit për të depozituar shumën 1,000,000 lekë në Raiffeisen Bank.

Referuar të dhënave nga Raiffeisen Bank në llogarinë e subjektit të rivlerësimit në euro janë transferuar shumat si më poshtë:

Datë	Shuma e transferuar në euro	Urdhëruesi
6.4.2016	1600	OSCE
6.7.2016	2094	Hague Academy
15.7.2016	450	OSCE
19.7.2016	1800	OSCE
6.12.2016	1800	COE
Total	7744	

Gjendja e kësaj llogarie më datë **01.01.2016 ka qenë 2000,15 euro**, ndërsa më datë **12.12.2016 ka qenë 0.64 euro**.

Shuma e tërhequr për periudhën 01.01.2016-12.12.2016 rezulton 9743.51 euro.

Nga analiza financiare rezulton se subjekti i rivlersimit ka patur mundësi financiare për depozitim e shumës prej 1.000.000 lekë në datë 12.12.2016 në llogarinë rrjedhëse në lekë, në emër të saj në Raiffeisen Bank, si dhe kalimin në obligacione në datë 22.12.2016. Në lidhje me burimin e të ardhurave për blerjen e këtyre obligacioneve subjekti i rivlerësimit ka deklaruar:

*“Për deklaratën e vitit 2016, jam me një detyrim prej **156,850 lekë**, për shkak të 3 pagesave si konsulente, me OSBE (3854 euro), Këshillin e Evropës (1800 euro) dhe Akademinë e Hagës (2090 euro), gjithsej **në shumën 7744 euro/1.045672 lekë**, me kursin lekë-euro baraz me 135,03 sipas kursit zyrtar të Bankës së Shqipërisë më 31 dhjetor 2016. Pagesa e detyrimit tatimor për vitet 2015, dhe 2016, është menduar të bëhet nga ana ime në momentin që DPT, nga sa jam interesuar unë pranë nëpunësve të saj, do të fillojë të merret me shqyrtimin dhe saktësimet mbi deklaratat e kaluara të viteve 2015-2016, dhe subjektet të cilat nga viti 2014, kur filloi fushata e ndërgjegjësimit për detyrimet mbi tatimin mbi të ardhurat personale, dhe plotësimi on line masivisht i DIVA për subjektet me mbi 20 milion të ardhura neto në muaj, kanë pasur pothuajse në të gjitha rastet, praktika të paqëndrueshme lidhur me keqplotësimet, ose dhe mosdeklarime apo mospagime të këtij detyrimi nga subjektet.”*

Në përfundim të hetimit ka rezultuar se :

- ⊗ Megjithëse subjekti i ka patur mundësitë financiare për krijimin e kësaj pasurie, ai nuk ka paguar detyrimet tatimore për të gjitha të ardhurat e deklaruara si burim për blerjen e obligacioneve, duke mos legjitimuar burimin e të gjitha të ardhurave.

Në lidhje me këtë rezultat të hetimit, subjektit iu kalua barra e provës. Së bashku me shpjegimet, Komisionit iu vu në dispozicion edhe fatura për pagesën e tatimit më datë 28.01.2019, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, për konsulencat nga projektet për vitin 2016, në vlerën 7744 euro/1047221.12 lekë, në shumën 195, 417.00 lekë, sipas përlllogaritjes me aktin përkatës tatimor.

Znj. Toska, në cilësinë e individit, kishte detyrimin të paguante tatimin mbi të ardhurat personale në kuptim të pikës dh) të nenit 8 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar. Neni 13/9 i po këtij ligji përcakton se për mosplotësim në kohë të deklaratës vjetore të të ardhurave, zbatohen sanksionet administrative, të përcaktuara në ligjin e procedurave tatimore. Neni 113 i ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, përcakton se të gjithë tatimpaguesit, përveç tatimpaguesit të tatimit mbi fitimin, që nuk dorëzojnë në afatin e përcaktuar sipas ligjit përkatës deklaratën tatimore, për të cilën detyrohen sipas ligjit të deklarojnë, dënohen me 5 000 lekë gjobë për çdo deklaratë tatimore të padorëzuar në afat. Pra, ligji tatimor nuk e pengon tatimpaguesin të shlyejë detyrimet tatimore

edhe me vonesë, për këtë ai është i detyruar të paguajë gjobën përkatëse, që llogaritet nga organi tatimor.

Nëpërmjet pagimit të tatimit është përmbushur edhe detyrimi ndaj buxhetit të shtetit, duke u ligjëruar kështu burimi i i të gjitha të ardhurave në favor të subjektit.

ii. Në lidhje me obligacione me afat 10-vjeçar (11.01.2018 – 11.01.2028) në shumën 732.081 lekë, rezulton se është pasuri e krijuar pas plotësimit dhe dorëzimit të deklaratës “Vetting”. Për këtë shumë është paguar edhe tatimi përkatës, bazuar në mandatpagesën e datës 06.04.2018 në Raiffeisen Bank, depozituar nga vetë subjekti.

Më datë 29.12.2017, subjekti i rivlerësimit ka depozituar *cash* në llogarinë nr. *** në euro në Raiffeisen Bank shumën 3020 euro, kjo shumë bashkë me gjendjen e llogarisë në vlerë 7552.87 euro është transferuar me konvertim në vlerën 1.000.000 lekë në llogarinë nr. *** në lekë në të njëjtën bankë, investuar për ankand më datë 11.01.2018. Nga ankandi është pranuar vetëm shuma 732.081 lekë dhe vlera e mbetur prej 267.919 lekë i është rikthyer në llogarinë rrjedhëse në lek në Raiffeisen Bank.

Referuar të dhënave nga Raiffeisen Bank në llogarinë e subjektit të rivlerësimit në euro janë transferuar shumat si më poshtë:

Datë	Shuma e transferuar në euro	Urdhëruesi
17.1.2017	3000	COE
19.1.2017	411,25	COE
3.2.2017	900	OSCE
6.3.2017	400	OSCE
9.6.2017	212	Save the children
21.6.2017	323,75	Conseil de L'Europe
10.11.2017	4000	Conseil de L'Europe
24.11.2017	3000	Conseil de L'Europe
Total	12247	

Gjendja e kësaj llogarie në datë **01.01.2017** ka qenë **0.69 euro**, ndërsa në datë **30.12.2017** ka qenë **90.17 euro**.

c. Llogari në valutë me gjendje 1,624 euro. Gjendja në datë 31.12.2016 ka qenë 0,69 euro; gjendja në datë 19.01.2017 është 444.25 euro.

Referuar të dhënave nga Raiffeisen Bank gjendja e kësaj llogarie në datë 31.12.2016 është 0.69 euro, ndërsa në datë 17.01.2017 është transferuar nga COE shuma 3000 euro dhe në datë 19.01.2017 shuma 411.25 euro, si dhe është tërhequr cash në datë 18.01.2017 shuma 2967 euro.

d. Llogari “KID” V. T. në shumën 10, 000 lekë.

Vajza e subjektit të rivlerësimit, znj.V. T., bazuar në shkresën e Raiffeisen Bank, rezulton se ka llogari në lekë me gjendje 40,002.49 lekë. Bazuar në nxjerrje e llogarisë rezulton se në datë 06.01.2017 subjekti i rivlerësimit ka depozituar shumën 10,000 lekë në llogarinë e vajzës së saj në Raiffeisen Bank.

Në përfundim të hetimit administrativ për këto llogari bankare pranë Raiffeisen Bank, pas kryerjes së analizës financiare të të ardhurave të subjektit, Komisioni konstaton se:

- ✓ Përputhet deklarimi i subjektit me të dhënat e administruara gjatë hetimit;
- ✓ Subjekti ka patur mundësi financiare për krijimin e këtyre depozitave/llogarive bankare.

3. Kursime në *cash*: Gjendja: 9.500 euro.

Burimi i deklaruar i krijimit sipas deklaratës VETTING: Pagat nga “****”, 4.630 euro, kursime ndër vite, paga nga institucioni i Avokatit të Popullit, 5.094.577 lekë;

Për këtë pasuri, subjekti ka vënë në dispozicion:

- Deklaratë personale, datë. 24.1.2017;
- Për gjendjen *cash* në shumën 9.500 euro.
- Vërtetim nga studio ligjore “****” datë 19.01.2017;
- Për të ardhura neto në shumën 4.630 euro në periudhën korrik 2006 — mars 2007
- Vërtetim nga Avokati i Popullit nr. *** prot., datë 20.01.2017 shoqëruar me tabelë;
- Për të ardhura neto në shumën 155.440 lekë në periudhën 1.9.2000 — 31.12.2000
- Vërtetim nga Avokati i Popullit nr. *** prot., datë 20.01.2017 shoqëruar me tabelë;
- Për të ardhura neto në shumën 496.753 lekë në periudhën 1.1.2001 — 31.12.2001
- Vërtetim nga Avokati i Popullit nr. *** prot., datë 20.01.2017 shoqëruar me tabelë;
- Për të ardhura neto në shumën 832.760 lekë në periudhën 1.1.2002 — 31.12.2002
- Vërtetim nga Avokati i Popullit nr. *** prot., datë 20.01.2017 shoqëruar me tabela;
- Për të ardhura neto në shumën 865.696 lekë në periudhën 1.1.2003 — 31.12.2003
- Vërtetim nga Avokati i Popullit nr. *** prot., datë 20.01.2017 shoqëruar me tabelë;
- Për të ardhura neto në shumën 868.239 lekë në periudhën 1.1.2004 — 31.12.2004
- Vërtetim nga Avokati i Popullit nr. *** prot., datë 20.01.2017 shoqëruar me tabelë;
- Për të ardhura neto në shumën 880.907 lekë në periudhën 1.1.2005 — 31.12.2005
- Vërtetim nga Avokati i Popullit nr. *** prot., datë 20.01.2017 shoqëruar me tabelë;
- Për të ardhura neto në shumën 874.172 lekë në periudhën 1.1.2006 — 31.12.2006

- Vërtetim nga Avokati i Popullit nr. *** prot., datë 20.01.2017 shoqëruar me tabelë;
- Për të ardhura neto në shumën 120.610 lekë në periudhën 1.1.2007 — 16.2.2007

Hetimi i kryer nga ana e Komisionit:

- Shkresë nr. *** prot., datë 29.10.2018, drejtuar studios ligjore “****”;
Studio ligjore “****” ka kthyer përgjigje me shkresën ref.nr. *** datë 19.11.2018
- Shkresë nr. *** prot., datë 29.10. 2018, drejtuar Avokatit të Popullit;
Avokati i Popullit ka kthyer përgjigje me shkresën nr. ***prot., datë 05.11.2018
- Shkresë nr. *** prot.,datë 20.12.2018 drejtuar Departamentit të Administratës Publike
Kthim përgjigje DAP nr. *** prot.,datë 11.01.2019

✚ Konstatimi i ILDKPKI-së për këtë pasuri:

Fshehje e gjendjes *cash* nga ana e subjektit në deklaratat e interesave private deri në vitin 2016. Për periudhën nga data 16.2.2006 – 16.2.2007 subjekti ka punuar në “****” dhe njëkohësisht është trajtuar me pagë si ndihmëskomisionere nga Avokati i Popullit. Subjekti duhej të deklaronte fillimin e marrëdhënieve të punës pranë shoqërisë “****” për të mos vazhduar me përfitimin e të ardhurave nga institucioni i Avokatit të Popullit.

Arsyetimi ligjor:

A. Në vitin 2006 subjekti i rivlerësimit deklaroi të ardhurat nga institucioni i Avokatit të Popullit “si e larguar për konflikt interesi”, në shumën **852.312 lekë**, ndërkohë në po të njëjtën deklaratë deklaroi dhe të ardhura nga studio ligjore “****” si avokate për konsulentë ligjore në shumën **2.700 euro**.

Sipas përgjigjes së studios ligjore “****”, subjekti i rivlerësimit ka qenë punëmarrëse pranë këtij subjekti në periudhën korrik 2006 – mars 2007, gjatë së cilës ka realizuar të ardhura neto në shumën **4.630 euro**, të cilat i kanë kaluar nëpërmjet pagesave në llogarinë e saj bankare në ProCredit Bank.

Duke qenë se rezultoi i paqartë pozicioni i subjektit në lidhje me këtë rezultat të hetimit, pasi është pyetur nga ana e Komisionit, ajo sqaroi se: “*Nuk kam qenë e dypunësuar, por e larguar dhe e paguar deri në 1 vit sipas legjislacionit të kohës.*” Në përputhje me të drejtën e saj për të kërkuar punë dhe për të punuar në sektorin privat, për sa kohë që në shërbimin civil ku bënte pjesë nuk po i ofrohej asnjë vend pune, nga data 01.04.2006, ka filluar të punojë tek ***, me 3 muaj periudhë prove, pa të drejtë page. Pas kësaj periudhe 3 - mujore, pra, nga data 1 korrik 2006 deri në 31 mars 2007, është paguar pranë “****”.

Nga ana e Komisionit i është kërkuar informacion Departamentit të Administratës Publike nëse sipas ligjit të kohës ndalohej që një nëpunës i vendosur në listë pritje nga një institucion shtetëror të mund të punonte pranë një subjekti privat.

Nga ana e DAP-it jemi informuar se: *“Bazuar në nenin 23 të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 “Për statusin e nëpunësit civil”, nëpunësi civil vazhdon të gëzonte të drejtat e vendit të tij të mëparshëm, derisa atij t’i ofrohej një vend tjetër, por jo për më tepër se një vit. Referuar kësaj dispozite, si dhe akteve nënligjore në bazë e për zbatim të tij, nuk rregullohej e drejta e lidhjes së marrëdhënieve të punës në sektorin privat, të nëpunësit civil, gjatë qëndrimit të tij në listë pritje.”*

Për sa më sipër rezulton se në ligjin e kohës nuk ka patur një rregullim ligjor ndalues në lidhje me punësimin në sektorin privat të një nëpunësi të vendosur në listë pritje nga një institucion shtetëror. Komisioni vlerëson se konstatimi i ILDKPKI-së nuk qëndron.

B. Nga ana e subjektit të rivlerësimit **nuk rezulton** që të jetë deklaruar në asnjë prej deklaratave të saj të interesave private kursime **cash në shumën 9.500 euro** me burim të ardhura nga pagat e shoqërisë “****” dhe kursime nga pagat e marra nga Avokati i Popullit. Këto kursime janë deklaruar në deklaratën “Vetting”.

Në lidhje me këtë konstatim subjekti i rivlerësimit sqaron se: *“Nga viti 2003 deri në vitin 2012, unë nuk kam pasur asnjë gjendje cash në shtëpi, prandaj dhe nuk kam deklaruar. Në shkurt 2012, janë tërhequr nga IATA 14.660 euro nga 20.000 euro depozita, për shkak të prishjes së marrëveshjes me IATA-n. Kjo gjendje cash është e njëjta me pjesën që mbeti nga tërheqja e depozitës IATA në shkurt 2012. Nga viti 2012 deri në deklaratën “Vetting” në 2017, cash në shtëpi nga tërheqja kanë mbetur gjendje 9,500 euro.”*³

*I kam deklaruar si të krijuara nga puna ime me burime të ligjshme, përkatësisht, paga nga “****”, paga nga Avokati i Popullit, plus kursime ndër vite, pasi sikundër shpjegova më lart, unë kam dhënë shpeshherë për nevojat e “****” sh.p.k, hua nga të ardhurat e mia. Nuk janë të reja, apo të krijuara rishtazi, por të transformuara si destinim në fillim tek IATA, dhe tek mbulimi i shpenzimeve për “****” sh.p.k, pastaj cash për nevoja në familje, të përdorura herë pas herë.*

*... Gjithsesi, kjo ka qenë një pakujdesi e imja që nuk më shkarkon nga detyrimi që duhet ta kisha deklaruar si cash, nga viti 2012 e lart, por theksoj se janë të njëjtat euro që i kam përfshirë tek biznesi “****” sh.p.k me IATA - n, apo në vitet në vazhdim 2007-2010 për nevojat e “****” sh.p.k, dhe që i rimorëm në shkurt 2012.*

*Mund t’i kisha deklaruar edhe në emër të bashkëshortit tek deklarata “Vetting”, por fakti është se për shkak të dhënies hua herë pas here për nevojat e “****” sh.p.k nga kursimet, dhe paga ime ndër vite, 2004-2010, kjo gjendje cash me vërtetësi, transparencë dhe sinqeritet nga të dy ne, pa pasur asnjë lloj prapamendimi për fshehje apo frikë nga deklarimi, pasi sido të jetë kjo shifër mbulohet nga të ardhurat e mia të ligjshme, është përfshirë tek kursimet e mia, tek deklarata e pasurisë “Vetting, 2017.”*

³ Pjesërisht janë harxhuar dhe për shlyerje të kësteve të makinës, pasi në Dhjetor 2012 i kërkuam bankës Credins Leasing, një plan tjetër financiar me kësht mujor 373 euro. Pra, kontratën e makinës Opel Astra, nga një plan 5 vjeçar e kaluam në plan 3 vjeçar shlyerje.

Për të provuar deklaratimet e saj subjekti i rivlerësimit ka vendosur bashkëlidhur “Njoftim Debiti” të Bankës Intesa San Paolo Bank nga ku rezulton se në datë 23.02.2012 nga ana e z. M. T. në cilësinë e administratorit të shoqërisë “****” sh.p.k, nga llogaria e kësaj shoqërie, është tërhequr shuma 14.660 euro. Por subjekti nuk ka depozituar asnjë dokument provë të huave që i ka dhënë “****” sh.p.k në shumën 9500 euro.

Referuar të dhënave nga Raiffeisen Bank, rezulton që në llogarinë e shoqërisë “****” sh.p.k nr. *** në euro, në datë 06.03.2007 është derdhur shuma 20.000 euro, dhe në datë 08.03.2007, është bllokuar shuma 20.000 euro, si garanci për IATA. Ka transfera të përmuajshme me përfitues IATA Albania.

Në datë 11.02.2009 është kaluar në llogari të kësaj shoqërie shuma 20.000 euro me përshkrimin “çlirim kolaterali, anulim garancie”, në të njëjtën datë është tërhequr shuma 20.000 euro, nga administratori M.T.

Referuar të dhënave për lëvizjet bankare nga Intesa San Paolo Bank, të shoqërisë “****” sh.p.k me shkresën nr. *** prot, datë 26.12.2018, rezulton që në datë 11.02.2009, në llogarinë nr. *** në euro, është depozituar cash shuma 20.000 euro me përshkrim “cash depozit M. T. garanci bankare për IATA” dhe në të njëjtën datë është transferuar shuma e mësipërme pa përfitues të përshkruar (përshkrimi internal transfer).

Në datë 31.01.2012, është transferuar me përshkrimin “Internal transfer” në këtë llogari, shuma 5300 euro dhe në datë 22.02.2012 shuma 14.700 euro. Në datë 23.02.2012 është tërhequr *cash* nga M. T. shuma 14.660 euro. Komisioni konstatoi se nuk është dokumentuar kalimi i këtyre të ardhurave në pronësi të familjes Toska, megjithëse ato janë tërhequr nga llogaria e shoqërisë “****” sh.p.k, nga administratori i shoqërisë.

Në përfundim të hetimit, subjektit iu kalua barra e provës në lidhje me:

- ⊗ Subjekti ka deklaruar kursime *cash* në shumën 9, 500 euro për herë të parë në deklaratën “Vetting” dhe nuk i ka deklaruar ato në deklaratat periodike.
- ⊗ Subjekti duhet të provojë me dokumentacion shumat e dhëna hua shoqërisë “****” sh.p.k ndër vite.

Për të sqaruar barrën e provës, subjekti ka vënë në dispozicion të Komisionit relacionin e financieres, kontabiliste e miratuar znj. M.Ç., e cila ka përpiluar bilancin e shoqërisë “****” sh.p.k për vitin 2007, sipas kontratës së shërbimit. Në këtë relacion jepen detaje të huave të dhëna nga Elsa Toska tek shoqëria. Ky relacion shoqërohet edhe me mandatefaturat në shumën 9180 euro, për vitet 2007-2009, që “****” sh.p.k ka arkëtuar hua nga subjekti, sa vijon:

Mandat nr. ***, datë 01.03.2007	125.000 lekë, ku shënohet në mandat "për depozitën IATA", arkëtuar nga familja (Elsa)" ky mandate ka korrigjim të valutës nga euro në lekë
---------------------------------	--

Mandat nr. ***, datë 01.03.2007	1000 euro Elsa, ku shënohet në mandat "për IATA", (Komisioni e disponon nga pyetëtori nr. 2)
Mandat nr. ***, datë 17.01.2007	1430 euro, ku shënohet "marrë borxh Elsës"
Mandat nr. ***, datë 13.03.2008	250.000 lekë ku shënohet "arkëtoi Elsa Toska" (ka korrigjim numri)
Mandat nr. ***, datë 30.06.2008	650 euro, ku shënohet "marrë borxh Elsës"
Mandat nr. ***, datë 11.09.2008	1500 euro ku shënohet "marrë borxh Elsës"
Mandat nr. ***, datë 30.01.2009	1630 euro ku shënohet "marrë borxh Elsës"
Gjithsej	6210 euro plus 375.000 lekë me kursin 1euro 126 lekë/2970 euro = 9180 euro
Mandat pagese nr. ***, datë 13.03.2008	M. T. dalje për këmbim në euro 250,000 lekë

Në shpjegimet me shkrim, subjekti ka përshkruar: *"...një praktikë të plotë, se si ka funksionuar huaja mes meje dhe tim shoqi dhe që pastaj ai e kalonte tek "****" sh.p.k. Kështu, me mandatin nr. ***, datë 13.03.2008, i cili bashkëlidhur ka dhe tërheqjen nga llogaria ime e bankës Raiffeisen, im shoq ka arkëtuar 250.000 lekë. Për nevojat e "****" sh.p.k, ai pastaj po në të njëjtën datë ka bërë daljen e kësaj huaje për ta kthyer në euro me mandatin nr. ***, datë 13.03.2008, ku shënohet "dalje për këmbim në euro". Gjeni ju lutem këtë praktikë si provë të huas së dhënë nga mua tek im shoq, dhe pastaj ai tek "****" sh.p.k të dokumentuar, ose shprehur në terma biznesore dhe ligjorë, "huatë e mia për ****".*

Më tej subjekti sqaron: *"Marrëdhënia mes tim shoqi dhe meje dhe "****", ka nuancat e një marrëdhënie sa familjare, aq dhe biznesore, prandaj dhe pajtohem me KPK, kur evidenton kontradiktat në deklaratimet e mia. Unë huatë, ia kam dhënë tim shoqi si individ në mirëbesim, prandaj dhe nuk kam patur si qëllim që t' i vërtetoj me dokumente, veprime që i lejon dhe Kodi i Procedurës Civile. Megjithatë, im shoq, në korrektesën maksimale, ka patur kujdes t'i dokumentojë, me aq dokumentacion sa kemi gjetur, si për mua dhe për të motrën e tij, dhe që reflektohet dhe në bilancin e shoqërisë për vitin 2007."*

Siç rezulton nga hetimi, edhe gjatë kësaj periudhe 2012-2016, shuma prej 14.660 euro është përdorur nga shoqëria "****" sh.p.k për shlyerjen e detyrimeve që kjo shoqëri kishte ndaj të tretëve. Pas përfundimit të hetimit administrativ, shqyrtimit të provave dhe shpjegimeve të subjektit, si dhe pasi e dëgjoi atë në seancë, Komisioni konstaton se gjendja *cash* në shumën prej 9500 euro deklarohet si kursime për herë të parë në deklaratën "Vetting". Kjo shumë duhet të ishte deklaruar që në momentin e krijimit të saj si kursime *cash* në deklaratimet periodike.

Por detyrimi kushtetues i subjektit është plotësimi me vërtetësi dhe saktësi i një deklaratë të re, deklaratës "Vetting". Komisioni konstaton se subjekti ka qenë korrekt në këtë deklaram. Nga ana tjetër, me provat e vëna në dispozicion Komisionit, subjekti ka arritur të provojë huadhënien tek "****" sh.p.k. Nga analiza financiare rezulton se subjekti i ka patur aftësitë financiare për këtë huadhënie. Subjekti, gjithashtu ka arritur të provojë kthimin e kësaj huaje nga bashkëshorti, me cilësinë e administratorit dhe ortakut të vetëm të "****" sh.p.k

Në përfundim, Komisioni vlerëson se:

- ✓ Subjekti ka arritur të bindë për burimin e ligjshëm të të këtyre kursimeve *cash* në shumën 9500 euro.
- ✓ Subjekti ka munguar të kryejë deklarin e kësaj gjendje *cash* për periudhën 2012-2016, por, Komisioni çmon se ky fakt në vetvete është i pamjaftueshëm për të passjellë zbatimin e dispozitave të parashikuara nga neni 61 i ligjit nr. 84/2016.

3. Në lidhje me llogaritë bankare të B. T.

Llogari “FUTURA” B. T. në lekë; gjendja: 38.940,47 lekë;

Llogari “FUTURA” B. T. në euro, gjendja: 10.424 euro.

Për këtë pasuri, subjekti ka vënë në dispozicion:

Nxjerrje llogarie Intesa San paolo Bank në emër të Znj. B. T.;

Nxjerrje llogarie Intesa San paolo Bank në emër të Znj. B. T.

Hetimi i kryer nga ana e Komisionit:

- Shkresë nr. *** prot., datë 04.06.2018 drejtuar bankave të nivelit të dytë.
- Shkresë nr. *** prot., datë 12.06.2018 kthim përgjigje Intesa San Paolo Bank.

Arsyetimi ligjor:

A. Bazuar në shkresën e Intesa San Paolo Bank rezulton se vajza e subjektit të rivlerësimit, B. T., ka patur llogari bankare pranë kësaj banke.

Referuar të dhënave bankare, llogaria në lekë në emër të vajzës është krijuar më datë 11.07.2007, me një depozitim *cash* nga ana e saj në vlerë 10.000 lekë; kjo llogari ka patur këtë ecuri:

	gjendje në
31dhjetor/lek	
2007	15000
2008	25769
2009	27456
2010	56944
2011	31383
2012	33295
2013	35312
2014	37283
2015	38224
2016	38940

- ✓ Përputhet deklarimi i subjektit më të dhënat e administruara nga hetimi administrativ.

B. Referuar të dhënave nga Intesa San Paolo Bank, llogaria në euro në emër të vajzës së subjektit të rivlerësimit, B. T., është krijuar në datë 11.07.2007, me një derdhje në konvertim në vlerë 39.76 euro e më pas në datë 21.06.2007 depozitim *cash* nga e subjektit të rivlerësimit në shumën 150 euro.

Gjendja e kësaj llogarie në datë 31.12.2016 është 10.224.99 euro. Në datë 06.01.2017 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 10.424.99 euro.

31dhjetor	gjendje në euro
2007	189,76
2008	245,47
2009	353,31
2010	982,49
2011	519
2012	986,8
2013	1807,96
2014	3836,46
2015	8357,96
2016	10224,99

Krijimi i kësaj llogarie nuk është deklaruar në deklaratimet periodike 2007-2012, por në deklaratimin periodik të vitit 2013. Referuar analizës financiare për periudhën 2007-2016, subjekti rezulton me balancë pozitive të fondeve.

Në përfundim konkludohet se:

- ✓ Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e administruar nga hetimi administrativ.

4. Nëna e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit ka patur llogari bankare pranë Intesa San Paolo Bank.

- a. Në llogarinë në lekë janë transferuar dy herë shumat 14,732 lekë me emërtimi dëmshpërblim për ish-të dënuarit politikë të regjimit komunist.
- b. Në llogarinë në euro janë transferuar shumat si më poshtë:

Data	Përshkrimi	Shuma euro
21.1.2003	Incoming TRF Paid	1493
8.4.2003	Incoming TRF Paid	1493
24.3.2004	Incoming TRF Paid	382

21.7.2004	Incoming TRF Paid	300
15.9.2004	Incoming TRF Paid	200
1.12.2004	Incoming TRF Paid	1383
25.8.2005	Incoming TRF Paid	2330
26.6.2006	Incoming TRF Paid	2350
27.2.2007	Incoming TRF Paid	4980
<hr/>		
Totali		14911

Në lidhje me këto transferime subjekti i rivlerësimit sqaron se: *“Burimi i krijimit të këtyre të ardhurave janë pagat nga punësimi i kumatës, vërtetuar me kontratat e punës. Këto të ardhura janë dërgesa në formë ndihme financiare nga motra e tim shoqi për nënën e saj dhe babain, që në atë kohë ishte gjallë dhe i sëmurë rëndë. Ai ka vdekur në qershor 2003 dhe deri në atë kohë kishte dhe pensionin e vet të pleqërisë si ish-ushtarak. Sikundër kam sqaruar unë jam martuar në dhjetor 2003, kohë kur kam filluar dhe bashkëjetesën, kështu që nuk kam pasur dijeni të hollësishme lidhur me këto ndihma. Pagesa e fundit e bërë në datë 27.02.2007 është huaja e kërkuar për IATA -n nga im shoq, të cilën unë e kam deklaruar si hua në DPV 2007.”*

Bashkëlidhur subjekti i rivlerësimit ka vendosur një deklaratë, nëpërmjet së cilës znj. M. T. deklaron se në datë 26.02.2007 i ka dërguar shumën 5.000 euro z. M. T. dhe transferimi i parave është bërë në llogarinë e nënës së saj. Kjo deklaratë dhe dokumentacioni plotësues i saj në gjuhën gjermane nuk janë dokumenta të mjaftueshëm për të provuar të ardhurat e zonjës M. T., sepse nuk përmbajnë të dhëna mbi aftësitë financiare të saj (paga).

Subjektit iu kalua barra e provës për të provuar mundësitë financiare të kumatës së saj zonjës znj. M. T. në shumën 14, 911 euro.

Subjekti, së bashku me shpjegimet e tij, ka vënë në dispozicion të Komisionit edhe tri kontrata pune të znj. M. T. për periudhën 2003 - deri aktualisht, në gjuhën gjermane, por edhe të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara për përkthimin, vetëm faqen e parë mbi natyrën e punës dhe pozicionit të saj, si dhe faqen ku shprehet neni përkatës me pagën e saj. Nga analizimi i këtyre kontratave rezulton se motra e subjektit të rivlerësimit ka patur të ardhura të mjaftueshme për të dërguar shumat përkatëse tek nëna e bashkëshortit të saj, si dhe për të dhënë hua në shumën 5.000 euro. Bazuar në këto kontrata rezulton se në viti 2006 e lart, paga e saj bruto ka qenë, 55.000 euro në vit.

- ✓ Nga shqyrtimi i këtij dokumentacioni konstatohet se zonja M. T. ka patur mundësitë financiare për këtë shpenzim të kryer.

5. Në lidhje me likuiditetet e subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj:

- Shkresë nr. *** prot., datë 04.06.2018 drejtuar bankave të nivelit të dytë;
Kthim përgjigje ALPHA Bank nr. *** prot., datë 06.06.2018
- Shkresë QKB-së nr. *** prot., datë 04.06.2018
Kthim përgjigje nr. *** prot., datë 21.06.2018
- Shkresë nr. *** prot datë 04.06.2018 drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve
Kthim përgjigje nr. *** prot., datë 14.06.2018
- Shkresë e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve drejtuar Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë
nr. *** prot., datë 14.06.2018
Kthim përgjigje nr. *** prot., datë 25.06.2018
- Shkresë nr. *** prot., datë 30.10.2018 drejtuar Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë
Kthim përgjigje nr. *** prot., datë 19.11.2018
- Shkresë nr. *** prot., datë 26.10.2018, drejtuar Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore
Tiranë
Kthim përgjigje nr. *** prot., datë 31.10.2018.
- Shkresë nr. *** prot., datë 30.10 2018 drejtuar Unionit Financiar Tiranë
Kthim përgjigje nr. *** prot datë 08.11.2018
- Shkresë nr. *** prot., datë 30.10.2018 drejtuar AK Invest
Kthim përgjigje nr. *** prot., datë 5.11.2018
- Shkresë nr. *** prot., datë 20.12.2018 drejtuar Bankave në lidhje me llogaritë e *** sh.p.k
Kthim përgjigje Raiffeisen Bank nr. *** prot., datë 24.12.2018
Kthim përgjigje Intesa San paolo Bank nr. *** prot., datë 26.12.2018
- Shkresë nr. *** prot., datë 27.12.2018 drejtuar Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë
Kthim përgjigje nr. *** prot, datë 27.12.2018
- Shkresë nr. *** datë 15.01.2009 drejtuar Gjykatës Kushtetuese
Kthim përgjigje nr. *** prot., datë 17.01.2019

Konstatimi i ILDKPI-së

- Subjekti në deklaratën e interesave private “Para fillimit të detyrës 2007”, ka deklaruar hua 5.000 euro kumatës znj. M. T. dhe hua 10.000 euro z. P. S. Në deklaratën e interesave private 2009, gjendja e detyrimit për huatë e marra është 6.050 euro z. P. S. dhe 2.550 euro znj. M. T., më pas, ndër vite, subjekti për këto detyrime nuk ka deklaruar më ndryshime. Këto huamarje nuk rezultojnë të deklaruara në deklaratën e rivlerësimit “Vetting”.

- Deklarim i rremë mbi të ardhurat e deklaruara nga dividend i shoqërisë “****” sh.p.k. dhe deklarim i pasaktë për të ardhurat nga paga e bashkëshortit pranë kësaj shoqërie.
- Fshehje e shitjes së kuotave të shoqërisë “****” në deklaratën e interesave private periodik vjetor 2005.
- Mosdeklarim në deklaratën e rivlerësimit “Vetting” të huave në shumat 5.000 euro marrë motrës M. T. dhe 10.000 euro z. P. S., hua të deklaruara në deklaratat e interesave private ndër vite.

Arsyetimi ligjor:

A. Bazuar në të dhënat e QKB-së rezulton se:

Bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit figuron administrator dhe ortak i vetëm i shoqërisë “****” sh.p.k regjistruar me vendim nr. *** datë 10.10.1997 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, pajisur me NIPT ***. Statusi aktual i shoqërisë “pezulluar”. Pezullimi është bërë që në datë 13.11.2013.

Nga krahasimi i të dhënave të administruara gjatë hetimit administrativ me deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në lidhje me pagën e bashkëshortit të saj dhe të ardhurave të përfituara nga dividendi si ortak i vetëm i shoqërisë *** sh.p.k., rezulton se ka mospërputhje, pasi bashkëshorti i saj në cilësinë e ortakut të vetëm të shoqërisë nuk ka shpërndarë asnjëherë dividend.

Është pyetur subjekti i rivlerësimit në lidhje me dividendin e tërhequr nga bashkëshorti i saj në përgjigjen e saj ajo sqaron se: *“Nuk ka dokumentacion provues për shpërndarjen e dividendit dhe tatimet e paguara për të, pasi shoqëria “****” sh.p.k nuk ka shpërndarë dividend. Është pasaktësi në deklarim.”*

Subjekti i rivlerësimit ka pranuar faktin që ka qenë e pasaktë në deklaratimet e saj për sa i përket dividendit të shpërndarë. Ndërkohë në deklaratën “Vetting” në lidhje me të ardhurat e përfituara nga dividendi, subjekti i rivlerësimit deklaron se: *“Për pagat si administrator dhe dividend si ortak i vetëm shih deklaratat e pasurisë 2004-2016.”*

Në përfundim të hetimit ka rezultuar se:

- ⊗ Subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë e saktë në deklaratimet e saj në deklaratën “Vetting” dhe në deklaratat periodike në lidhje me të ardhurat e përfituara nga dividendi nga ana e bashkëshortit të saj.

Subjektit iu kalua barra e provës në lidhje me këtë rezultat të hetimit.

Në lidhje me këtë pasaktësi, të konstatuar nga ana e Komisionit, por edhe nga ana e ILDKPKI-së, subjekti bie dakord pjesërisht me gjetjet. Sipas saj, “****” sh.p.k. ka shpërndarë dividend në 2007 dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve nuk është korrekte kur pohon që nuk ka shpërndarë

asnjëherë dividend kjo shoqëri. Për të provuar këtë, subjekti ka vënë në dispozicion vendimin e ortakut të vetëm nr. ***, datë 25.06.2008, për shpërndarje dividendi në 2007, depozituar në QKB, në shumën 427,674 lekë dhe detyrimin për pagesë dividendi në shumën 42,767 lekë. Më tej subjekti sqaron: *“Kam bërë deklaramë, sipas asaj që më ka thënë im shoq në lidhje me pagën e tij apo dividendët, referuar bilanceve modeste të shoqërisë. Këto pasaktësi të miat në deklarata periodike vijnë si të trashëguara nga problematikat e “***” sh.p.k, deri në 2013, kur u pezullua aktiviteti, dhe në deklaratën “Vetting”, unë thjesht kam thënë: “administrator dhe i vetëpunësuar tek “***” 2007 -2010”. Për pagat si administrator dhe dividendi si ortak i vetëm, shih deklaratat e pasurisë 2004-2016), po nisur në parim, nga ideja që kështu kam pasur deklaruar ndër vite në DPV, 2003 - e lart. Unë nuk ndërmora një proces verifikimi dhe saktësimi de facto të situatës së ***, gjatë deklaramit “Vetting”. Gjatë asaj periudhe jam përpjekur maksimalisht të gjeja dokumentet të lidhura me të ardhurat e mia personale, sikundër dhe pothuajse i gjeta të gjitha, ndërsa për tim shoq thjesht deklarova gjendjen aktuale të tij, pra llogaritë bankare dhe pagën nga punësimi në “***”, e bindur dhe e vetëdijshme, që burimet e mia të ligjshme 2003 - 2017, mbulonin pasurinë tonë modeste. Si përfundim, nuk kam realizuar një vlerësim profesional financiar të të ardhurave të bashkëshortit nga “***” (fitimet ose dividendi), për qëllimet e plotësimit të deklaramit “Vetting”, por thjesht reflektova në të faktin e deklarameve vjetore periodike, pa u futur në shifra konkrete. Gjithsesi, këto pasaktësi, që i konstatova vetëm gjatë formulimit të përgjigjeve të pyetësorit nr. 2 të Komisionit, nuk kanë sjellë asnjë pasojë financiare në pasurinë time të deklaruar në deklaramin “Vetting”, pasi unë nuk kam vënë asnjë pasuri, të luajtshme, apo të paluajtshme, nga të ardhurat e tim shoqi. Kështu që, vlerësoj se nuk duhet marrë në konsideratë situata financiare e tim shoqi dhe marrëdhëniet e tij me organet tatimore, apo pasaktësitë që vijnë sa nga padijenja mbi njohuritë financiare, sa nga konteksti biznesor i asaj kohe, dhe sa nga paaftësia paguese dhe pamundësia financiare e ***”.*

Nga hetimi rezultoi se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka qenë ortak i vetëm i shoqërisë “***” me NIPT *** nga 05.11.1999-07.06.2005. Në datë 03.06.2005 bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit me kontratë nr. *** i ka shitur kuotat e tij për shumën 100,000 lekë z. P. S.

Shitja e kuotave të shoqërisë “***” nuk rezultoi e deklaruar në deklaramin “Vetting”, por dhe në deklaramin e interesave private ndër vite të subjektit të rivlerësimit. Duke marrë në konsideratë shumën e vogël të shitjes së kuotave si dhe faktin që kjo shumë nuk është përdorur si burim për blerjen e pasurive të luajtshme apo të paluajtshme të subjektit të rivlerësimit kjo pasaktësi nuk ka elementet e nevojshëm në kuptim të neneve 33 e 61 të ligjit nr. 84/2016 për t’u konsideruar si një shkak autonom për shkarkimin e subjektit.

Pasi shqyrtoi shpjegimet e subjektit, si dhe provat e vëna në dispozicion prej tij, Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka qenë i saktë në deklaramin e të ardhurave të bashkëshortit nga dividendi, por është fakt që këto të ardhura nuk ndikojnë në rezultatin financiar apo nivelin pasuror të subjektit për sa kohë nga ana e saj nuk janë deklaruar asnjëherë si burim për krijimin e pasurive.

Komisioni konkludon se:

- ✓ Pasaktësitë në deklaram nga subjekti nuk vlerësohen se cenojnë vlerësimin e pasurisë së tij.

B. Në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës të datës 24.04.2007 bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka deklaruar si më poshtë:

1. Garanci 20.000 euro IATA;
2. Hua znj. M. T. 5.000 euro. Në lidhje me këtë hua subjekti i rivlerësimit ka vijuar të deklarojë shlyerjen e saj si më poshtë:

Viti	Deklarimi
2007	Nuk deklaroi shlyerje
2008	Mbetur pa shlyer 3.000 euro M. T., por nuk deklaroi se ka shlyer 2.000 euro
2009	450 shlyer mbetur 2.550 euro
2010-2016	Nuk deklaroi

Subjekti i rivlerësimit nuk ka bërë më deklarime pas vitit 2010, si dhe nuk e ka pasqyruar këtë hua në deklaratën “Vetting”.

Në lidhje me këtë konstatim është pyetur subjekti i rivlerësimit, e cila sqaron si më poshtë:

“Nuk disponoj dokumentacion provues, pasi marrëdhënia e kunatës me tim shoq është e ngushtë familjare. Nuk kemi menduar se kjo shlyerje duhej bërë me shkrim, veprim që e lejon dhe neni 233/ç i Kodit të Procedurës Civile. Për më tepër, sa herë që kunata ka ardhur për vizitë tek nëna e saj dhe tek familja jonë, ne kur kemi patur mundësi brenda hapësirave tona të kursimit, i kemi shlyer shumën të vogla në cash, ose i kemi dhënë lekët e biletave për në Gjermani, ose im shoq i ka blerë për ardhjen e saj në Shqipëri.

- Shkurt 2007, 5000 euro hua;

- Nëntor 2007, 2000 euro kthim huaje cash;

- Mars 2009, huaja mbeti 2550, që unë e kam deklaruar në DPV të vitit 2009, pasi i ishte shlyer 450 euro;

- Shkurt 2010, i është blerë biletë M. në vlerën 440 euro dhe huaja i zbriti në 2110 euro

- Mars 2011, në vlerën 342 euro i është paguar biletë M. dhe huaja zbriti në 1768 euro

- Korrik 2012, në shumën 410 euro, duke e zbritur në 1358 euro;

-Maj 2015, 500 euro kthim huaje cash

-Gusht 2016 e mbyllur përfundimisht si hua, prandaj dhe nuk është deklaruar në formularin “Vetting” 2017.

Në shkurt 2012, kemi bërë prishjen e kontratës me IATA, dhe tërheqjen e vetëm 14.660 eurove, nga Intesa San Paolo⁴, pasi rreth 5340 euro u mbajtën si detyrime ndaj linjave ajrore, që vërteton

⁴ Krijimin e garancisë “***” e realizoi me Raiffeisen Bank në mars 2007, kurse tërheqjen nga IATA e realizoi me Intesa San Paolo në Shkurt 2012, pasi për shkak të komisionit të lartë të Raiffeisen Bank, *** e kishte spostuar këtë

vështirësitë ekonomike të tim shoqi në atë kohë dhe faktin se biznesi nuk ishte më aspak fitimprurës. Një pjesë e huas kumatës, e mbetur nga shkurt 2012, i është shlyer nga tërheqja e garancisë IATA. Ne kishim pas shkurtit 2012, 14.660 euro cash dhe një pjesë e tyre janë përdorur dhe për shlyerje huaje ndaj kumatës. Pra, burim i ligjshëm i shlyerjes ka qenë vetë mbetja financiare nga IATA dhe kursimet familjare, si dhe nga të ardhurat e mia me pagat dhe mësimdhënien.

*Gjithashtu, vlerësoj se edhe pse tërheqja e huas është bërë nga llogari bankare të vjehrrës sime, bashkëshorti si administrator dhe ortak i vetëm i ***, e ka pasur marrëdhënie biznesi këtë hua, kështu që ajo i përket legjislacionit tregtar, për rrjedhojë edhe pse është deklaruar nga unë, në fakt nuk duhej deklaruar.”*

Ndërkohë subjekti i rivlerësimit më datë 17.12.2018 ka korigjuar përgjigjen: “Ndërsa në pyetjen 4a, kam gabuar me periudhën e shlyerjes së huasë ndaj kumatës. Në fakt shumën prej 2000 euro, ia kemi shlyer në mars 2008 dhe jo në nëntor 2007, sikundër kam sqaruar.”

Subjekti i rivlerësimit nuk është treguar i qartë në deklaratimet e tij në lidhje me këtë marrëdhënie. Nëse i referohemi deklaratës të znj. M. T., huaja nuk i është dhënë shoqërisë “***”, por z. M. T.

Subjektit iu kalua barra e provës për të vërtetuar me dokumentacion shlyerjen e huas në shumën 5.000 euro zonjës M. T.

Për të provuar marrjen e huasë dhe shlyerjen e saj nga kunata, znj. M. T., subjekti ka vënë në dispozicion të Komisionit mandatarkëtimin nr. ***, datë 01.03.2007, ku arkëtohet shuma 5000 euro hua znj. M. T. nga “***” sh.p.k. Subjekti argumenton se ky veprim korrespondon me tërheqjen që ka bërë nga llogaria e nënës së tij, bashkëshorti i saj, më datë 27.02.2007, të shumës prej 5000 euro të dërguar nga e motra, si dhe me bilancin e vitit 2007, zëri “***”.

Subjekti ka vënë në dispozicion të Komisionit vërtetimin e lëshuar nga kunata, e cila konfirmon shlyerjen e huas prej 500 euro deri në muajin gusht 2016, mandatpagesën nr. ***, datë 13.03.2008, në vlerën 2000 euro shlyerje huaje, lëshuar nga “***” për M. T., si dhe mandatpagesën, nr. ***, datë 13.03.2008 në shumën 350 euro. Subjekti ka shpjeguar se pas vitit 2009, huaja është larë ndër vite me vlera të vogla, duke blerë bileta avioni për znj. M. T. dhe duke i dhënë cash në vlera të vogla, kur vinte në Shqipëri. Subjekti ka pretenduar se “mbase kjo është arsyeja pse unë kam harruar të vazhdoj deklarinimin me larjen e huasë pas vitit 2009”.

Nga shpjegimet e subjektit dhe provat e dorëzuar prej saj rezulton se kjo hua është marrë nga “***” si shoqëria tregtare dhe person juridik më vete, por për shkak të faktit se z. M. T. ka qenë administrator dhe ortak i vetëm i kësaj shoqërie, subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar këtë hua ndërkohë nga ana e saj kjo hua nuk ka qenë e detyrueshme për t’u deklaruar për sa kohë kemi të bëjmë me një marrëdhënie të një subjekti tregtar.

- ✓ Në përfundim, Komisioni i ka konsideruar bindëse provat dhe shpjegimet e dhëna nga subjekti.

garanci tek banka Intesa San Paolo. Mund t’ju vëmë në dispozicion dokumentacion provues lidhur me këto marrëdhënie dhe lëvizje garancie.

3. Hua z. P. S. 10.000 euro. Për këtë hua subjekti i rivlerësimit ka vijuar të deklarojë shlyerjen si më poshtë:

Viti	Deklarimi
2007 para fillimit të detyrës	10.000 euro
2007 periodik	Borxhi si garanci hipotekore për agjencinë “***” 5.500 euro shlyer mbetur 7.500 euro
2008	Shlyer 1000 euro nga detyrime 10.500 euro mbetur 6.500 euro
2009	450 euro mbetur 6050 euro
2010-2016	Nuk deklaroi

Në lidhje me këtë hua subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë i saktë në deklarin e vlerës reale të saj pasi në vitin 2007 në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës e deklaroi 10.000 euro, në vitin 2007 në deklaratën e interesave private periodike e deklaroi 13.000 euro dhe në vitin 2008 në deklaratën e interesave private periodike e deklaroi 10.500 euro, ndërsa pas vitit 2010 nuk deklaroi më. Kjo hua nuk është pasqyruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën “Vetting” për sa kohë nuk ka dokumentacion për të provuar shlyerjen e saj.

Në lidhje me këtë konstatim është pyetur subjekti i rivlerësimit e cila sqaron si më poshtë:

*“Pas mbi 10 vitesh nuk arrij të mbaj mend arsyen, por besoj se nuk ka pasur arsye, **thjesht pasaktësi njerëzore**. Kështu, unë vetë nuk i disponoj DPV 2006 dhe 2007, por duke qenë se për vitin 2006, detyrimi i deklaramit shtrihej deri në 31 mars 2007, dhe 13.000 euro i ka tërhequr bashkëshorti në 1 mars 2007, tek DPV 2007, kam sqaruar qartësisht shumë e saktë të huas së marrë dhe se sa ishte shlyer. Gjithsesi, vlerësoj se këto veprime nuk duheshin deklaruar, pasi nuk përfshihen tek objekti i deklaramit për hua personale, sipas nenit 4/dh të ligjit nr. 9049/2003, për deklarin e pasurive. Kjo hua prej 13.000 euro nuk ka qenë hua e imja apo e personi të lidhur, por e “***” ndaj “***”. Detyrimi im ka qenë të deklaroja pagat e bashkëshortit si administrator, kuotat si ortak i vetëm dhe dividendët, sipas nenit 4/ç të ligjit nr. 9049/2003. Dokumentacioni i *** nuk disponohet më i plotë nga bashkëshorti, që nga mbyllja e agjencisë. Sikundër paraqita, huaja i është marrë “***” dhe për rrjedhojë dhe shlyerja i është bërë “***”. Kjo shlyerje ka patur këtë historik:*

- Qershor 2007, u shlyen 4000 euro nga “***”, (2000 euro me transferta bankare nga “***” në “***”, maj 2007, bashkëgjitur dokumenti bankar. Po ashtu dhe 2000 euro cash nga bashkëshorti tek llogaria e “***”. I është kërkuar dokumenti bankës “Intesa San Paolo”, e cila i ka verifikuar dhe pranon që i ka në sistem këto derdhje dhe do të na verë në dispozicion dokumentin.

- Gusht 2007 iu shlyen 1000 euro, nga fitimet e “***” (bashkëgjitur mandati i pagesës)

- Dhjetor 2007, u shlyen 500 euro, nga fitimet e “***”

- Mars 2008, iu shlyen 500 euro nga fitimet e “***”

-Dhjetor 2008, iu shlyen 1000 euro nga fitimet e “***”

-Tetor 2009, iu shlyen 450 euro nga fitimet e “***”, duke e zbritur huan në **6050 euro**, që unë e kam deklaruar në DPV të vitit 2009.

Nga viti 2010, im shoq dhe z. P. S. kanë konkluduar verbalisht, se huaja është larë për shkak detyrimesh të ndërsjellta, që i kanë pasur njëri- tjetrit, ndër vite. Gjithashtu, dua t'ju informoj se bashkëshorti im dhe z. P. S. kanë qenë shokë fakulteti për 5 vite, dhe, pas diplomimit në 1989 i ka karakterizuar një shoqëri e ngushtë dhe marrëdhënie e posaçme shoqërore.

Nga 2010 nuk i janë paguar më hua “****”, dhe kjo ka qenë arsyeja që unë kam ndalur së deklaruar huan ose larje huaje nga bashkëshorti im lidhur me IATA-n, dhe as nuk e kam deklaruar në deklaratën “Vetting”.

Si burim të ligjshëm të shlyerjes së huave, kemi përdorur kryesisht fitimet nga “**”, por edhe kursimet familjare nga paga dhe mësimdhënia ime.**

Marrëdhëniet mes “****” dhe “****”, janë marrëdhënie biznesi që rregullohen nga e drejta tregtare dhe legjislacioni tatimor, kështu që edhe pse janë deklaruar nga mua, në fakt nuk duheshin deklaruar. Mund t'i referoheni bilanceve të “****” ndër vite dhe mund t'ju vëmë dhe dokumentacion në dispozicion nëse është e nevojshme për të vërtetuar mungesën e korrektesisë nga organet shtetërore apo tatimore, lidhur me ofrimin e biletave nga “****” ose shërbime cargo dhe mosbërjen e pagesave nga ana e tyre, si dhe aplikimin e “****” për rimbursim TVSH-je në shumën 500.000 lekë, akoma e parimbursuar edhe aktualisht.”

Ndërkohë subjekti i rivlerësimit në datë 17.12.2018 deklaroi se:

“Kështu në pyetjen 3b, ku më është kërkuar të sqaroj shlyerjen e huas ndaj “****”, gabimisht kam vënë shlyerje në mars prej 500 euro. Nuk ka pasur shlyerje ndaj “****” në këtë periudhë.”

Bashkëlidhur subjekti i rivlerësimit ka vendosur:

- Mandat arkëtimi nr. *** datë 01.03.2007 për shumën 13.000 euro;
- Mandat pagesë nr. *** datë 21.08.2007 shuma shkruhet 1.000 euro;
- Transfertë datë 7.05.2007 për “****” me përshkrim në marrëdhënie me mandat nr. *** / datë. 01-mar-2007
- Tërheqje 13.000 euro në Intesa San Paolo Bank e datës 01.03.2007 me numër reference *** nga llogaria e “****” ku si personi që ka tërhequr këtë shumë, rezultoi z. M. T.

Në lidhje me këtë hua subjekti i rivlerësimit është i paqartë në deklaratimet e saj. Ajo deklaroi se kjo hua është lidhur midis dy shoqërive tregtare, por ndërkohë si burim për shlyerjen e kësaj huaje deklaroi se janë përdorur kursimet e saj familjare.

Deklarimet e subjektit të rivlerësimit në lidhje me shlyerjen e kësaj huaje nuk përputhen me deklarinin periodik të vitit 2007 si më poshtë:

Viti	Deklarimi gjatë hetimit	Deklarimi Periodik
2007	7.500	5.500

Gjithashtu subjekti i rivlerësimit deklaroi se kjo hua u shua verbalisht për shkak të detyrimeve reciproke që bashkëshorti i saj dhe z. P. S. kishin ndër vite.

Referuar bilancit kontabël të shoqërisë “****” për periudhën 01.01.2007-31.12.2007 (dërguar nga DRT-ja Tiranë me shkresën nr. *** prot., datë 19.11.2018), nuk rezultojnë në zërin detyrime (të kërkueshme pas më shumë se një vit apo deri në një vit), hua të tjera apo të tjera detyrime, nuk janë vendosur vlera.

Sa më sipër huatë e marra të deklaruara nuk janë evidentuar në llogaritë kontabël dhe bilancin kontabël të vitit 2007.

Gjithashtu edhe në pasqyrat financiare për periudhën 01.01.2008-31.12.2008 shoqëria “****” sh.p.k nuk ka deklaruar huamarrje për vlerat e mësipërme.

Mbështetur në informacionin e dërguar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, me shkresën nr. *** prot., datë 27.12.2018, rezulton se shoqëria “****”, regjistruar me NIPT ***, nuk ka të deklaruar në llogaritë vjetore (gjendjet financiare) periudha 01.01.2007-31.12.2007, në aktive të qëndrueshme financiare, kredi ose hua të dhëna (rreshti nr.20)

Referuar të dhënave për lëvizjet bankare nga Intesa San Paolo Bank, të shoqërisë “****” sh.p.k me shkresën nr. *** prot., datë 26.12.2018, rezulton që nga llogaria nr. *** në euro:

-në datë 27.10.2006, është transferuar shuma prej 6.900 euro me përfitues shoqërinë “**** ” (nuk përcaktohet qëllimi i transfertës);

-në datë 05.02.2007 në llogarinë në lek të kësaj shoqërie është transferuar shuma 628.000 lekë, në po të njëjtën datë shuma 627.000 lekë është transferuar me këmbim në llogarinë në euro në këtë bankë në shumën 5.020.02 euro, dhe shuma 3500 euro është transferuar për shoqërinë “**** ” nga M. T. “pa përshkrim të hollësishëm”;

-në datë 07.05.2007 nga llogaria në euro pranë kësaj bankë të shoqërisë “****” sh.p.k, është transferuar shuma prej 2000 euro me përfitues shoqërinë “****”.

Në përfundim të hetimit ka rezultuar se:

- ⊗ Deklarimet e subjektit të rivlerësimit nuk përputhen me dokumentacion kontabël të shoqërisë “****” sh.p.k dhe “****”.
- ⊗ Subjekti nuk provon me dokumentacion provues (a) shlyerjen e huas z. P. S. si dhe (b) burimin e ligjshëm të ardhurave për dhënien e kësaj huaje nga zoti S.

Subjektit i kaloi barra e provës në lidhje me këto rezultate të hetimit.

Për të dhënë sqarimet e veta, subjekti i është referuar relacionit të hartuar nga kontabiliste e miratuar znj.M. Ç., në lidhje me realizimin e bilancit të vitit 2007. Sipas këtij relacioni, rezulton, hua ndaj *** në shumën 7500 euro, në 31 dhjetor 2007, aq sa subjekti ka deklaruar në DPV periodik 2007, përkatësisht: "Borxhi si garanci hipotekore për agjencinë “****”. 5.500 euro shlyer, mbetur 7.500 euro". Subjekti ka sqaruar, mbështetur në relacionin e kontabilistes, se: “Shuma prej 20.000 euro është konsideruar si derdhje ortaku, prandaj nuk figuron në listën e furnitorëve. Në llogarinë "shuma të arkëtuara për porosi" del gjendja e huas ndaj “****” në shumën 7500 euro. Marrëdhëniet me këtë shoqëri kanë qenë marrëdhënie bashkëpunimi, prandaj dhe kjo shoqëri del edhe si debitore ndaj “****”, në shumën 3500 euro". Subjekti ka depozituar, së bashku me shpjegimet edhe deklaratën e z. A. M., si ortak i vetëm i “****”, i cili konfirmon marrëdhënien e huas për IATA mes dy shoqërive, si dhe shlyerjen e kësaj huaje.

Për të sqaruar në mënyrë shteruese këtë situatë, subjekti ka detajuar historikun e marrëdhënies së huasë të marrë për IATA, duke e konsideruar si një marrëdhënie mes dy shoqërive, pavarësisht

nuancave që e bashkëshoqërojnë, edhe si marrëdhënie shoqërore, që ka filluar që nga viti 1984, periudhë shkollimi në universitet.

Subjekti ka depozituar:

- Tërheqja e bërë nga M. T., administrator dhe ortak i vetëm i *** shpk me NIPT ***, me datë 01.03.2007, pranë Intesa Sanpaolo Bank, me numër mandati ***, në vlerën prej 13,000.00 euro është hua e marrë nga “****” për të realizuar garancine bankare për akreditimin e kësaj agjencie në IATA.

- Arkëtimet/derdhjet në “****” nga “****”, sipas detajeve të mëposhtme:

a) Mandat 07/05/07 A/C TO A/C TRANSFER *** 07/05/07, 2 000 euro, ***/ TRFR TO *** SHPK /në marrëdhënie me mandat nr. *** /datë.01-mar-2007.

b) Mandat nr. ***, datë 21.06.2007, Banka Intesa San Paolo, 2 000 euro cash nga bashkëshorti tek llogaria “****”. Në mandat thuhet: M. T. / NË MARRËDHËNIE ME MANDAT NR *** DATË 1 MARS 07.

c) Mandatpagesë nr. ***, datë 21.08.2007, vlera 1000 euro, paguar tek financa e “****”, ku thuhet në marrëdhënie me mandatin e Intesa San Paolos. ***, të datës 1 mars 2007.

ç) mandatpagesë nr. ***, datë 03.12.2008, në vlerën 1000 euro *cash* në marrëdhënie me ***, të datës 1 mars 2007.

e) mandatpagesë nr. ***, datë 31.10.2007, në vlerën 500 euro në marrëdhënie me mandat arkëtimin ***.

Komisioni konstaton se subjekti ka vërtetuar me dokumentacion burimin e ligjshëm të shumës prej 20 000 euro të depozituara si garanci bankare për marrëdhënien biznesore me IATA. Historiku i marrëdhënieve tregtare mes dy shoqërive, si shoqëri që kanë bashkëpunuar duke ofruar reciprokisht kontribute nga aktivitetet e veta, konstatohet edhe nga të dhënat bankare të shoqërive, si dhe hetimi i kryer.

Sa i përket aftësisë financiare të z. P. S., bazuar në sa u dokumentua më lart, konstatohet se nuk ka qenë hua mes dy individëve, por ndërmjet dy shoqërive. Ky fakt pranohet edhe nga subjekti, duke rezultuar me një përshkrim të gabuar të kësaj marrëdhënie tregtare. Nga shpjegimet e subjektit dhe provat e dorëzuar prej tij rezulton se kjo hua është marrë nga “****” si shoqëri tregtare dhe person juridik më vete, por për shkak të faktit se z. M. T. ka qenë administrator dhe ortak i vetëm i kësaj shoqërie, subjekti e ka deklaruar këtë hua, megjithëse nga ana e saj kjo hua nuk ka qenë e detyrueshme për t’u deklaruar për sa kohë kemi të bëjmë me një marrëdhënie midis dy subjekteve tregtare.

- ✓ Në përfundim, Komisioni vlerëson se, pavarësisht përshkrimit të gabuar të marrëdhënies së huas midis shoqërisë në pronësi të bashkëshortit me atë të zotit P. S., duke e paraqitur atë si marrëdhënie individuale, subjekti ka arritur të paraqesë prova dhe shpjegime bindëse për marrjen dhe shlyerjen e kësaj huaje nga “****” sh.p.k.

Pasuritë e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit dhe nënës së tij

- 6. Shtëpi banimi, apartament, 61,4 m², në bashkëpronësi me 1/4 ndërtuar në vitin 1963, blerë nga Ndërmarrja Komunale Banesa nr. 1, në vitin 1993 (bashkëngjitur kontrata) me çmimin 8.248 lekë, por shuma e paguar është 6.874 lekë, duke u ulur 20% për shkak pagese të menjëhershme. Pjesa takuese: ¼ ose 25%, bashkëpronësi e katër personave.**
- 7. Aplikim për legalizim të një shtese anësore prej 23 m² tek ALUIZNI, në korrik 2006 (bashkëngjitur kërkesa drejtuar ALUIZNI-t për vërtetimin) Shtesë e ndërtuar në vitin 1995. Në bashkëpronësi me 1/3 pjesë takuese.**

Subjekti ka vënë në dispozicion:

- Kontratë shitblerje, viti 1993, për blerje apartamenti me sip. 61.4 m², me palë blerëse: A., N., M. dhe M. T., me palë shitëse: Ndërmarrja Komunale Banesa nr. 1 Tiranë. Çmimi sipas kontratës 6.874 lekë;
- Vërtetim nënshkrimi kontrate nr. *** datë 19.11.1993;
- Kontratë për privatizim në banesë datë 09.08.1993, ndërmjet Ndërmarrja Komunale Banesa dhe qiramarrësit A.T. Çmimi sipas kontratës 6.664 lekë, shoqëruar me planimetrinë dhe plan vendosjen e apartamentit;
- Dëftesa për pranimin e objekteve postare datë. 20.1.2017, dërgues M.T. dhe marrës ALUIZNI Tiranë.

Hetimi i kryer nga Komisioni:

- Shkresë nr. *** prot., datë 04.06.2018 drejtuar Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme; Kthim përgjigje ZVRPP-ja Tiranë nr. *** prot., datë 26.06.2018.
- Shkresë nr. *** prot., datë 04.06.2018 drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të ALUIZNI-t;

Kthim përgjigje ALUIZNI nr. *** prot., datë 13.06.2018

Kthim Përgjigje ALUIZNI Tiranë 2, nr. *** prot., datë 25.06.2018

KONSTATIMI I ILDKPKI-së

Në deklaratën e rivlerësimit subjekti nuk ka paraqitur dokumente për legalizimin e shtesës së apartamentit, nuk ka deklaruar vlerën e investuar nga bashkëshorti në vitin 1995, shtesa e cila është fshehur nga subjekti në deklaratat e interesave private ndër vite.

Arsyetimi ligjor:

Në vitin 1993 me kontratë shitblerje është blerë apartamenti me sipërfaqe 61.4 m². Çmimi sipas kontratës 6.874 lekë. Nga ana e ZVRPP-së Tiranë, konfirmohet se bashkëshorti i subjektit të

rivlerësimit ka në bashkëpronësi me ¼ pjesë takuese pasurinë me nr. ***, zona kadastrale ***, e llojit apartament me sip. 61.4 m², e ndodhur në Rr. “****”, p. ***, shk. ***, k. ***, ap. ***, Tiranë. Në lidhje me deklarinimin e shtesës anësore të apartamentit, nga shkresa e ALUIZNI Tirana-2 nr. *** prot., datë 25.06.2018, konfirmohet se subjekti M. A. T. është vetëdeklarues bashkë me banorë të tjerë (8 familje) për shtesë anësore me sipërfaqe 23,5 m². Bashkëlidhur shkresës janë: formular vetëdeklarimi nr. *** prot., datë 31.08.2006, kërkesë për kalimin në pronësi të shtesës anësore dhe të truallit publik datë 31.08.2006, certifikatë familjare (familja Toska), 2 fotografi me pamje të objektit, kontratë shitblerje e vitit 1993 me Ndërmarrja Komunale e Banesa nr. 1. Bazuar në dokumentacion e dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit në datë 11.12.2018, kjo shtesë është legalizuar me lejen nr. *** në vitin 2018 dhe sipërfaqja është 28 m².

Nga verifikimi i deklaratave të interesave private të subjektit të rivlerësimit rezulton se kjo shtesë nuk është deklaruar nga viti 2003-2016, por në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës të datës 24.04.2007 tek seksioni deklarata e interesave private e bashkëshortit të saj rezulton se ai ka deklaruar se ka në pronësi apartament me sipërfaqe 81 m² me vlerë 18,000 lekë. Nëse mbledhim sipërfaqen e apartamentit së bashku me shtesën sipërfaqja totale rezulton 84.4 m².

Në lidhje me këtë shtesë është pyetur subjekti i rivlerësimit, e cila sqaron si më poshtë:
“Shtesa është bërë në 1994, de facto. Është futur në proces legalizimi në 2006. Unë nuk kam asnjë kontribut financiar për ndërtimin e shtesës, pasi jam martuar në vitin 2003. Gjithsej, është vetëdeklaruar 23 m², sipas matjeve inxhinierike kur është aplikuar, por nga ALUINI ka rezultuar një sipërfaqe tjetër rreth 28 m². Shpenzimet modeste për këtë shtesë anësore të katit të tretë, janë mbuluar nga bashkëshorti im, vjehri dhe vjehrra. Dokumentacioni që disponojnë për këto shpenzime të bëra në 1994, është në total për të gjithë banoret e shkallës, saktësisht 8 familje që bënë shtesën, për sa vijon:

- Preventiv i gërmimeve të dheut në shumën 90.850 lekë;
- Punime gërmimesh e ndërtimesh në shumën 580.000 lekë;
- Punime gërmimesh e ndërtimesh në shumën 37.300 lekë;
- Projekti i shtesës;
- Një dokument gjeodezie dhe faturë pagese.

Sipas familjes së bashkëshortit, ka kushtuar pak, dhe ndoshta tek dokumentet për aplikim tek ALUIZNI është dhënë një shumë e përafërt vetëm për shtesën e tyre. Gjithë dokumentacionin për ndërtimin e shtesës në total për të gjithë familjet e shkallës 4 dhe sa ka kushtuar ajo, i keni bashkëngjitur. Shtesa është legalizuar së fundmi dhe bashkëngjitur, gjeni ju lutem lejen e legalizimit lëshuar nga ALUIZNI.”

Në përfundim konkludohet se konstatimi i ILDKPKI-së nuk është i saktë, shtesa e apartamentit prej 23 m² është kryer në vitin 1995, subjekti është martuar në vitin 2003, deklarimi i parë si subjekt rivlerësimi është bërë në vitin 2007.

✓ Përputhet deklarimi i subjektit me të dhënat e administruara gjatë hetimit administrativ.

Konkluzioni përfundimtar mbi vlerësimin e pasurisë së subjektit

Pasi u hetua në mënyrë të thelluar mbi të ardhurat, shpenzimet dhe pasuritë e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, rezultoi se subjekti i rivlerësimit Elsa Toska ka qenë e

saktë në deklarinimin e saj në deklaratën “Vetting”. Komisioni vlerëson se pasaktësitë në deklarimet ndër vite nuk kanë arritur nivel të mjaftueshëm për marrjen e masave të mëtejshme në kuptim të neneve 33 e 61 të ligjit nr. 84/2016.

Komisioni çmon se subjekti, pavarësisht se ka pasur pasaktësi në deklarime, përgjatë deklarimeve të pasurisë ndër vite, nuk ka pasur për qëllim të fshehë apo paraqesë në mënyrë të pavërtetë pasurinë apo të ardhurat. Duke arsyetuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, duke vënë në balancë vlerën e këtyre pasaktësive, në raport me provat e tjera të administruara nga Komisioni, nëpërmjet hetimit të tij, Komisioni konstaton se subjekti ka arritur të argumentojë burimin e ligjshëm të pasurive dhe të ardhurave të veta, si detyrimi kryesor kushtetues i tij.

Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit, znj. Elsa Toska, ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.

B. VLERËSIMI I FIGURËS

Drejtorja e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjekti të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parahikuar në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Për këtë qëllim DSIK-ja ka dërguar një raport me shkresën nr. *** prot., datë 30.10.2017 për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016. Sipas këtij raporti, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklarinimit për kontrollin e figurës, si dhe nuk ka informacione se subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar.

Si konkluzion DSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit znj. Elsa Toska.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

Këshilli i Lartë i Drejtësisë (KLD) ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe 5 dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar me nr. *** prot., datë 22.10.2018.

Raporti për analizën e aftësive profesionale kryer nga Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë është bazuar te:

- Formulari i vetëdeklarimit, të 3 dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjerë që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit:

1. **Dokumenti 1.** Opinion ligjor i datës 21.10.2013 për çështjen nr. S-15 regjistri, që i përket kërkuesit “***”, me objekt: “Shfuqizimin si antikushtetues të VKM-së nr. 200, datë 13.03.2013 “Për miratimin e kontratës së koncesionit për shërbimin e markimit dhe monitorimit të karburanteve”, të lidhur ndërmjet Ministrisë së Financave dhe bashkimit të përkohshëm të shoqërive “***”.

Opinion ligjor rezulton të jetë i plotë dhe mendimi i ndihmësit ligjor është i argumentuar. Ai përmban edhe propozimin për zgjidhjen konkrete të çështjes ku sugjerohet pranimi i kërkesës. Kjo çështje ka kaluar nga Kolegji për shqyrtim në seancë plenare, por në përfundim është vendosur rrëzimi i kërkesës. Mendimi i subjektit të rivlerësimit nuk përputhet me vendimin përfundimtar të Gjykatës Kushtetuese.

2. **Dokumenti 2.** Opinion ligjor i datës 05.12.2014 për çështjen nr. N-18 Regjistri, që i përket kërkuesit: 1/5 e Deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë, me objekt “Shpalljen antikushtetues të ligjit nr. 115/2014 “Për ndarjen territoriale administrative”

Në këtë opinion ligjor, mungon një konkluzion i përcaktuar shprehimisht, por nga leximi në tërësi të tij, konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka konkluduar se pretendimet e kërkuesit janë të pathemelta, jashtë juridiksionit kushtetues, nuk janë ngritur në nivel kushtetues dhe janë pretendime të bazuara në argumente hipotetike.

Kjo çështje ka kaluar nga Kolegji për shqyrtim në seancë plenare dhe në përfundim është vendosur rrëzimi i kërkesës. Mendimi i subjektit të rivlerësimit përputhet me vendimin e Gjykatës Kushtetuese.

3. **Dokumenti 3.** Opinion ligjor i datës 14.04.2016 për çështjen nr. S - 7 Regjistri, që i përket kërkueses: “***” dhe subjektit të interesuar: Kuvendi i Shqipërisë, me objekt: “Shpallja si antikushtetues të nenit 62/3 të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”.

Opinion ligjor i subjektit të rivlerësimit është i strukturuar në pjesë, nënpjesë dhe paragrafë të numërtuar. Ai rezulton të jetë i plotë, por mendimi i këshilltares ligjore për zgjidhjen e çështjes është evaziv. Kjo çështje ka kaluar nga Kolegji për shqyrtim në seancë plenare dhe në përfundim është vendosur pranimi i kërkesës. Mendimi me rezerva i subjektit të rivlerësimit përputhet me vendimin e Gjykatës Kushtetuese.

- Dokumentet ligjorë, të përzgjedhura me short sipas një sistemi objektiv dhe rastësor:

4. **Dokumenti 1.** Relacion i datës 27.03.2013 dhe opinion i datës 16.05.2013 për çështjen nr. S - 8 regjistri, që u përket kërkuesve: Këshilli Kombëtar i Personave me Aftësi të Kufizuar dhe Shoqata e të Verbërve të Shqipërisë, me subjekte të interesuar: Kuvendi, Këshilli i Ministrave dhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me objekt: “Deklarimin si të papajtueshëm me Kushtetutën, Konventën e OKB-së, KEDNj-në dhe Kartën Sociale Evropiane, të pikave 7 dhe 9 të nenit 3 të ligjit nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

Opinionii ligjor rezulton të jetë i plotë dhe mendimi i subjektit të rivlerësimit është i argumentuar. Ai përmban edhe propozimin për zgjidhjen konkrete të çështjes, që përputhet pjesërisht me vendimin përfundimtar të gjykatës.

5. **Dokumenti 2.** Relacion i datës 19.02.2014 për çështjen nr. G - 2 regjistri, që i përket kërkuesses: Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me objekt: “Shfuqizimin si të papajtuëshëm me Kushtetutën të nenit 70 pikat 1, 3 dhe 5 dhe nenit 72/a të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

Relacioni rezulton të jetë i plotë dhe mendimi i subjektit të rivlerësimit është i argumentuar. Ai përmban edhe propozimin për zgjidhjen konkrete të çështjes, i cili përputhet me vendimin e Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.

6. **Dokumenti 3.** Relacion i datës 21.04.2015 për çështjen nr. G - 5 regjistri, që i përket kërkuesses: Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me objekt: “Shfuqizimin si të papajtuëshëm me Kushtetutën i togfjalëshit “pa ndërprerë gjykimin e çështjes”, të paragrafit të dytë të nenit 64 të K.Pr.Civile”

Relacioni rezulton të jetë i plotë dhe mendimi i subjektit të rivlerësimit është i argumentuar. Ai përmban edhe propozimin për zgjidhjen konkrete të çështjes, që përputhet me vendimin e Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.

7. **Dokumenti 4.** Relacion i datës 09.05.2016 për çështjen nr. G - 17 regjistri, që i përket kërkuesses: Gjykata e Shkallës së Parë për Krimit e Rënda, me objekt: “Shfuqizimin e fjalëve ‘të mbetura’, të parashikuara në germat “a” dhe “b” të nenit 4 të ligjit nr. 154, datë 21.12.2015 “Për dhënie amnistie”, si në kundërshtim me nenin 17 pika 1 dhe nenin 18 pikat 1 dhe 3 të Kushtetutës”.

Relacioni rezulton të jetë i plotë dhe mendimi i subjektit të rivlerësimit është i argumentuar. Ai përmban edhe propozimin për zgjidhjen konkrete të çështjes, që përputhet me vendimin e Kolegjit të Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese.

8. **Dokumenti 5.** Relacion i datës 17.11.2014 dhe opinion i datës 22.11.2014 për çështjen nr. G - 27 regjistri, që i përket kërkuessesve: Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier dhe Avokati i Popullit, me objekt: “Deklarimi i kushtetueshmërisë së fjalisë së dytë, të paragrafit të pestë të nenit 610 të K.Pr.Civile *‘Kur titulli ekzekutiv është një akt për dhënien e kredive nga institucionet financiare jobankare dhe gjykata ka vendosur pezullimin e ekzekutimit të vendimit, masa e pezullimit konsiderohet si e rënë nga fuqia me kalimin e 20 ditëve nga momenti i dhënies së vendimit të pezullimit’.*”

Opinionii ligjor rezulton të jetë i plotë dhe mendimi i subjektit të rivlerësimit është i argumentuar, por ai nuk përmban propozimin për zgjidhjen konkrete të çështjes.

TË DHËNA NGA BURIME ARKIVORE TË KLD-SË

Subjekti i rivlerësimit Elsa Toska nuk ka të dhëna në burimet arkivore të KLD-së për periudhën e vlerësimit, për shkak të detyrës që ajo ka ushtruar në këtë periudhë.

VLERËSIMI I AFTËSISË PROFESIONALE TË SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Vlerësimi i aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit u bazua në gjetjet e mësipërme dhe pas një analize të bërë në përputhje me ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe Kreun II të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

1. Aftësitë profesionale

a) Njohuritë ligjore

Subjekti i rivlerësimit ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe të zbatimit të ligjit. Ajo njeh mirë parimet themelore të së drejtës kombëtare dhe ndërkombëtare për shkak të funksionit të këshilltares ligjore në Gjykatën Kushtetuese që nga viti 2007.

Në 3 dokumentet ligjore të paraqitura dhe 5 dokumentet ligjore të përzgjedhura me short tregojnë se subjekti i rivlerësimit ka njohuri mjaft të mira në të drejtën kushtetuese. Ajo është përfshirë në trajtimin e çështjeve të ndryshme kushtetuese, që lidhen me procedurat e ndryshme të gjykimit, duke përfshirë edhe kontrollin incidental të normave ligjore. Në themel, çështjet që ajo ka trajtuar lidhen parimet themelore të organizimit shtetëror apo me liritë dhe të drejtat themelore, siç janë liria ekonomike dhe kushti për kufizimin e saj vetëm me ligj, organizimi territorial në funksion të mirëqeverisjes dhe të drejtës së votës, liria e shprehjes me fokus lirinë e mediave audiovizive, barazia para ligjit dhe ndalimi i diskriminimit, procesi i rregullt ligjor në aspektet e gjykatës së caktuar me ligj, të paanshme dhe të pavarur.

b) Arsyetimi ligjor

3 dokumentat ligjorë të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit janë të shkruar qartë në mënyrë të kuptueshme dhe strukturuar. Edhe në 5 relacionet e vëzhguara të përzgjedhura me short, është ruajtur kjo strukturë arsyetimi.

Në të gjitha këto dokumente citohen rast pas rasti jurisprudenca e mëparshme e Gjykatës Kushtetuese dhe GjEDNj-së, dispozitat kushtetuese, vendime të Kuvendit dhe dispozitat e Kodit Zgjedhor, jurisprudenca e mëparshme e Gjykatës Kushtetuese, GjEDNj-së, Direktivat e BE dhe Konventat Ndërkombëtare, Akti i Paaftësisë në SHBA, ligji spanjoll mbi mundësi të barabarta, Akti mbi Paaftësinë në Angli, Magna Carta me Paaftësi e Filipineve, Akti i Diskriminimit në Australi, vendime të Gjykatës Federale Gjermane, jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese dhe e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese. Në opinionet e saj argumentohet mbrojtja kushtetuese që gëzojnë liritë dhe të drejtat e subjekteve fizikë dhe juridikë që cenohen nga aktet ligjore dhe nënligjore të organeve shtetërore.

2. Aftësia organizative

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Subjekti i rivlerësimit Elsa Toska në periudhën e rivlerësimit 08.10.2013-08.10.2016 ka ushtruar detyrën e këshilltares ligjore gjyqtares pranë Gjykatës Kushtetuese. Në funksionin pranë kësaj Gjykate, ajo ka deklaruar se në periudhën e rivlerësimit 08.10.2013 – 08.10.2016 ka përgatitur 23 draft opinione ligjore. Këto të dhëna të deklaruara prej saj në formularin e vetëvlerësimit, nuk dokumentohen me shkresë nga Gjykata Kushtetuese.

Ndërsa sipas informacionit zyrtar të Gjykatës Kushtetuese, rezultojnë të relatuara 21 çështje. Rendimenti i punës së saj nuk mund të përcaktohet pasi kuadri ligjor në fuqi nuk përcakton standarde minimale pune për këshilltarin ligjor të Gjykatës Kushtetuese.

b) Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore

Nga të gjitha praktikatat e administruara nuk ka dokumentim të veprimeve të kryera nga subjekti i rivlerësimit, me qëllim matjen saktësisht të kësaj aftësie. Nga përmbajtja e 8 dokumenteve ligjore konstatohet se këshilltarja ligjore ka studiuar çështjen që ka relatuar. Relacioni apo opinionin i hartuar prej saj përmban elementët e parashikuar në nenin 14/a të ligjit nr. 8577/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë” dhe nenit 27 të Rregullores së brendshme të Gjykatës Kushtetuese, të datës 15.06.2009 “Mbi gjykimin kushtetues dhe funksionimin e administratës”.

c) Aftësia për të administruar dosjet

Nga 5 dokumentet e përzgjedhur me short, në 5 raste rezulton se mendimi i këshilltarit ligjor është hartuar në varësi të procedurës përpara Gjykatës Kushtetuese në formën e relacionit (kur çështja ka qenë në shqyrtim paraprak) apo të opinionit (kur çështja ka qenë për shqyrtim në seancë plenare). Nga ana tjetër, duhet theksuar se asnjë prej dokumenteve të paraqitur dhe relacioneve të shortuara nuk identifikohet koha e marrjes për këshillim, por aktet e hartuara prej saj dokumentojnë në çdo rast datën e përfundimit, që i ka paraprirë në kohë vendimmarrjes së Gjykatës Kushtetuese. Një mangësi e evidentuar është mungesa e nënshkrimit në çdo akt të këshilltares ligjore, mangësi e cila duket që lidhet me praktikën e punës që është ndjekur në të gjithë Gjykatën.

3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

a) Etika në punë

Subjekti i rivlerësimit deklaroi se nga muaji maj 2007 deri aktualisht, ka ushtruar detyrën e këshilltares ligjore pranë Gjykatës Kushtetuese. Në periudhën e rivlerësimit, ajo është caktuar këshilltare e kryetarit të Gjykatës Kushtetuese.

Nga praktika dokumentare e administruar në funksion të procesit të rivlerësimit nuk ka të dhëna lidhur me etikën në punë për shkak se nuk ka qenë subjekt i Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

b) Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit dhe nga 8 dokumentat e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

c) Paanësia

Nga 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga 5 relacionet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit.

4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

a) Aftësitë e komunikimit

Në 8 dokumentet ligjore nuk ka të dhëna për mënyrën e komunikimit të subjektit të rivlerësimit me palët kërkuese, pasi për shkak të natyrës së punës, ajo prezumohet se nuk ka kontakt të drejtpërdrejtë me ta. Ndërsa gjuha e përdorur në akte është normale dhe komunikimi në përputhje me etikën profesionale.

b) Aftësia për të bashkëpunuar

Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 relacionet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta. Nuk janë konstatuar vonesa në relatin e çështjeve që të ketë sjellë problematikë në gjykimin e çështjes nga ana e Gjykatës Kushtetuese, kjo edhe për faktin se praktika e punës dhe veprimet e këshilltarit ligjor me dosjet përkatëse nuk evidentohen në regjistra për të matur parametrat e shpejtësisë dhe të sasisë në punë.

c) Gadishmëria për t'u angazhuar

Subjekti i rivlerësimit i ka kushtuar rëndësi formimit të saj akademik, me fokus të drejtën kushtetuese dhe të drejtat e njeriut. Ajo ka kryer studime pasuniversitare në të drejtën kushtetuese dhe studime evropiane në vitet 2003-2005, ku ka marrë titullin MA, si dhe titullin “Doktor” në vitin 2012 në Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin e Tiranës. Duke iu referuar deklarimeve dhe dokumenteve të paraqitura prej saj, konstatohet se ajo ka kryer edhe publikime profesionale të ndryshme.

Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pjesëmarrjen në cilësinë e lehtësueses në trajnimin me temë “*Res judicata* në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese” të organizuar nga Shkolla e Magjistraturës, në dy sesione dhjetor 2015 dhe qershor 2016. Megjithatë, ky angazhim i saj nuk dokumentohet rregullisht prej akteve të paraqitura prej saj.

Ndërkohë, gjatë periudhës së rivlerësimit, subjekti i rivlerësimit, është angazhuar edhe në 4 aktivitetet e mëposhtme, jashtë programit të Shkollës së Magjistraturës:

- i. “Trajnim i trajnerëve mbi mosdiskriminimin me fokus Romët dhe Udhëtarët”, të organizuar nga Këshilli i Evropës, për të cilin është lëshuar certifikata e datës 28.10.2016;
- ii. “Integriteti i nëpunësve civilë”, i organizuar nga Akademia e Hagës për Qeverisjen Vendosre, në Hagë, Hollandë, më 7-16 prill 2014;
- iii. “Lidershipi për Sigurinë dhe Shtetin e së Drejtës”, i organizuar nga Matra CoPROL, të organizuar më 10-19 shtator 2014, 18-27 mars 2015, 15-17 prill 2015 dhe 27-29 maj 2015 në Hagë, Hollandë dhe në Durrës, Shqipëri;
- iv. “Constitutional Court of Albania”, më 2-6 korrik 2014, organizuar nga Ambasada Turke.

Bazuar në pikën 2 të nenit 42 të ligjit 84/2016, si burim për rivlerësimin profesional, përveç relacioneve dhe mendimeve ligjore të përgatitura nga kjo këshilltare ligjore pranë Gjykatës Kushtetuese, shërbejnë edhe rezultatet e testimit pranë Shkollës së Magjistraturës.

Subjekti i rivlerësimit ka marrë pjesë në testimin e kryer nga kjo shkollë në datat 7-8 maj 2018.

Bazuar në shkresën nr. *** prot., datë 23.05.2018 të Shkollës së Magjistraturës konstatohet se subjekti, në fazën e parë, ka arritur të marrë 57 pikë nga 100 në total, ndërsa në fazën e dytë ka arritur të marrë 153 pikë nga 200 në total.

Në përfundim të kësaj analize, në lidhje me aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit Elsa Toska, konstatohet se ky subjekt ka treguar cilësi të mira në punë, arsyetim të drejtë, identifikon dhe analizon drejt problemet. Në disa raste mendimi i saj si këshilltare ligjore ka ndihmuar gjykatën në marrjen e vendimit. Ajo njeh mirë parimet e së drejtës, si respekton në arsyetim të drejtat e palëve, është efiçente dhe efektive.

Pranë Komisionit nuk ka asnjë denoncim për këtë subjekt.

D. KONKLUZIONI PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoji subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, konstaton se subjekti ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, një nivel të besueshëm të kontrollit të figurës, si dhe nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të nenit 58, pika 1, germa “a”, si dhe të nenit 59, pika 1, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Elsa Toska.
2. Vendimi i arsyetuar, me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, më datë 12.02.2019.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

VALBONA SANXHAKTARI

Kryesuese

LULZIM HAMITAJ

Anëtar

GENTA TAFA (BUNGO)

Relatore

Sekretare gjyqësore
IORELA MANDRO